# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6127
E mërkurë, 30 shtator 2020
çmimi 0.40 €


## Veseli thotë se PDK-ja do të rikthehet fuqishëm në zgjedhjet lokale

FAQE 6





Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


MBROJTJA KËRKON LIRIMIN E NASIM HARADINAJT NGA PARABURGIMI NË HAGË



# Nasim Haradinaj në Hagë: Nuk e kam njohur dhe nuk do ta njoh Gjykatën Speciale

Nënkryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK), Nasim Haradinaj, ka dalë të martën për herë të parë para Gjykatës së Dhomave të Specializuara në Hagë, nën dyshimet për pengim të drejtësisë. Gjatë paraqitjes së tij, Haradinaj ka përsëritur qëndrimin se nuk i njeh Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, që ndryshe njihet si Gjykata Speciale. “Nuk e kam njohur këtë gjykatë, nuk e njoh dhe nuk do ta njoh. Jeni me mandat të skaduar që nga 2 gushti”, ka thënë Nasim Haradinaj. Dhomat e Specializuara kanë njoftuar se kryetari i OVLUÇK-së, Hysni Gucati, do ta bëjë paraqitjen e parë para këtyre dhomave më 1 tetor FAQE 3

ANALISTËT POLITIKË HEDHIN POSHTË PRETENDIMET E KRYEMINISTRIT AVDULLAH HOTI SE QEVERIA ËSHTË STABILE

## ANALISTËT: QEVERIA ËSHTË E BRISHTË, GJASAT QË TË STABILIZOHET JANË ZERO

Njohësit e rrethanave politike në vend kanë bërë me dije se qeveria Hoti nuk i ka numrat e nevojshëm për ta qeverisur vendin. Imer Mushkolaj dhe Faton Abdullahu kanë deklaruar për gazetën “Epoka e re” se vazhdimi i punës së kësaj qeverie e cila nuk mund t’i kalojë ligjet e nevojshme në Kuvend do të krijojë dëme për vendin dhe qytetarët. Ata kanë vlerësuar se moskalimi i Projektligjit për rimëkëmbjen ekonomike për të pestën herë me radhë tregon për mosfunksionalitetin e këtij koalicioni qeverisës. Sipas tyre, rruga më e mirë për të dalë nga kjo situatë janë zgjedhjet e reja FAQE 4-5



## MBI 13 000 PACIENTË NË KOSOVË TË SHËRUAR NGA COVID-19

FAQE 7




## OPINION

### PSE PD-JA NUK VJEN DOT NË PUSHTET F. 11

Nga Bedri ISLAMI



## AKTUALE



### MË 3 NËNTOR DEBATI I PARË PRESIDENCIAL NË MES TË TRUMPIT DHE BIDENIT F. 2

### MBI 13 000 PACIENTË NË KOSOVË TË SHËRUAR NGA COVID-19 F. 7

## EKONOMI



### KRYEMINISTRI HOTI: DO TA SUBVENCIONOJMË DHE MBËSHTESIM PRODHIMIN VENDOR F. 9

### BQK-ja DHE MASH NËNSHKRUAJNË MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI PËR TEKSTET E EDUKIMIT FINANCIAR F. 8

## SPORT

### ARBËRIA NUK NJEH HUMBJE NË SUPERLIGË F. 13


RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

# Më 3 nëntor debati i parë presidencial në mes të Trumpit dhe Bidenit

UASHINGTON, 29 SHTATOR - Kandidatët presidencialë në Shtetet e Bashkuara, demokrati Joe Biden dhe presidenti Donald Trump, do ta zhvillojnë debatin e parë televiziv, nga tre debatet sa pritet të mbahen deri në mbajtjen e zgjedhjeve më 3 nëntor.

Debati 90-minutësh televiziv Trump-Biden, i cili fillon në 3:00 të mëngjesit, më 30 shtator, dhe do të moderohet nga moderatori i "Fox News", Chris Wallace, vjen mes tensioneve tregtare me Kinën, një rritje të numrit të vdekjeve nga koronavirusi dhe situatës së papunësisë në ShBA, ku dhjetëra miliona amerikanë janë pa punë.

Debati zhvillohet pas publikimit më 27 shtator të detajeve të pagesave federale të taksave të të ardhurave të Trumpit.

Raporti hulumtues u publikua nga "New York Times".

Për shkak të koronavirusit, akti tradicional i shtrëngimit të duarve para debatit është hequr. Bideni ka thënë se ai pret një sërë sulmesh personale nga Trumpi, i cili tashmë ka pohuar se demokrati 77-vjeçar "nuk e di se është gjallë", një referencë për moshën e Bidenit. Nga ana tjetër, Bideni e ka quajtur Trumpin, 74 vjeç, një "prani toksike" në Shtëpinë e Bardhë.

"Do të jetë e vështirë", tha Biden në një intervistë të transmetuar, më 26 shtator në MSNBC. Presidenti Trump u tha gazetarëve në Shtëpinë e Bardhë më 28 shtator, se ai "po pret me padurim debatin".

Rreth 100 milionë amerikanë pritet ta ndjekin debatin televiziv i cili është planifikuar të zhvillohet në Kleveland, Ohio, pa audiencë të drejtpërdrejtë të pranishme.



# Ministri Quni pritet me nderime të larta ushtarake në Turqi



ANKARA, 29 SHTATOR (ER) - Ministri i Mbrojtjes, Anton Quni, është pritur të martën me nderime të larta ushtarake në selinë e Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare të Turqisë. Në takim me homologun e tij turk Hulusi Akar, Quni ka biseduar për bashkëpunimin bilateral në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, si dhe për bashkëpunimin në fushën e industrisë së mbrojtjes.

Dy ministrat zhvilluan takimin kokë me kokë, për ta vazhduar pastaj kryesimin e takimit ndërmjet dy delegacioneve. Gjatë këtij takimi ministri Akar theksoi miqësinë ndërmjet Turqisë dhe Kosovës në përgjithësi dhe partneritetin e fuqishëm ndërmjet dy ministrive dhe forcave në veçanti. Ai theksoi nevojën e zhvillimit të mëtejshëm të marrëdhënieve të mira ndërmjet dy vendeve, ministrive dhe forcave si dhe rëndësinë e bashkëpunimin në të mirën e paqes, sigurisë dhe stabilitetit në rajon dhe më gjerë.

Ministri Quni ka falënderuar shtetin turk për mbështetjen që i ka dhënë FSK-së.

Në takim u diskutuan bashkëpunimi bilateral në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, si dhe bashkëpunimi në fushën e industrisë së mbrojtjes.

Në fjalën e tij, ministri i Mbrojtjes i Republikës së Kosovës, Anton Quni, shprehu falënderimin dhe mirënjohjen e thellë për rolin dhe kontributin e madh të shtetit, qeverisë dhe Forcave të Armatosura të Turqisë në ndërtimin dhe zhvillimin e gjithëmbarshëm të vendit tonë, vetë Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Sigurisë së Kosovës.

Ndër të tjera, ministri Quni ritheksoi se partneriteti me Republikën e Turqisë si vend shumë i rëndësishëm i NATO-s, Ministrinë e Mbrojtjes Kombëtare dhe Forcat e Armatosura të Turqisë do të vazhdojë të jetë i fuqishëm në perspektivën tonë zhvillimore për t'i arritur aftësitë, kapacitetet dhe standardet më të larta operacionale për ofrimin e shërbimit tonë ndaj paqes, sigurisë dhe stabilitetit rajonal dhe më gjerë.

## Gruevski dënohet me një vjet e gjysmë burg

SHKUP, 29 SHTATOR - Ish-kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Nikolla Gruevski, është dënuar me një vjet e gjysmë burg, ndërsa ish-ministri i Transportit, Mile Janakievski, me një vit burg me kusht. Ky i fundit nuk do të shkojë në burg nëse në katër vjetët e ardhshëm nuk e përsërit veprën.

Ata u shpallën fajtorë për veprën "nxitje dhe organizim të protestave të dhunshme" para ambienteve të Komunës "Qendër" në verën e vitit 2013. Të pandehurit, sipas prokurorisë, kishin organizuar turmën për të ndërhyrë në sallën e këshillit komunal me arsyetimin se janë kundër ndalimit të ndërtimit të një kishe në Shkup. Këshilli komunal drejtohet nga opozita e cila kundërshtonte planet e qeverisë për ndryshimin e planit urbanistik. Rasti është zbuluar nga afera e përgjimeve që ishte publikuar nga vitet 2013 deri në vitin 2014 nga lideri i atëhershëm i opozitës, Zoran Zaev.




EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Mbrojtja kërkon lirimin e Nasim Haradinajt nga paraburgimi në Hagë

# Nasim Haradinaj në Hagë: Nuk e kam njohur dhe nuk do ta njoh Gjykatën Speciale




**Nënkryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK), Nasim Haradinaj, ka dalë të martën për herë të parë para Gjykatës së Dhomave të Specializuara në Hagë, nën dyshimet për pengim të drejtësisë. Gjatë paraqitjes së tij, Haradinaj ka përsëritur qëndrimin se nuk i njeh Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, që ndryshe njihet si Gjykata Speciale. "Nuk e kam njohur këtë gjykatë, nuk e njoh dhe nuk do ta njoh. Jeni me mandat të skaduar që nga 2 gushti", ka thënë Nasim Haradinaj. Dhomat e Specializuara kanë njoftuar se kryetari i OVLUÇK-së, Hysni Gucati, do ta bëjë paraqitjen e parë para këtyre dhomave më 1 tetor**

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

Nënkryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Nasim Haradinaj. ka dalë të martën për herë të parë para Gjykatës së Dhomave të Specializuara në Hagë, nën dyshimet për pengim të drejtësisë. Gjatë paraqitjes së tij, Haradinaj ka përsëritur qëndrimin se nuk i njeh Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, që ndryshe njihet si Gjykata Speciale. "Nuk e kam njohur këtë gjykatë, nuk e njoh dhe nuk do ta njoh. Jeni me mandat të skaduar që nga 2 gushti", ka thënë Nasim Haradinaj.

Kundër Haradinajt ende nuk ka aktakuzë të ngritur, megjithatë Prokuroria në Hagë tha se këtë do ta bëjë së shpejti. Haradinaj u arrestua më 25 shtator në një lagje të Prishtinës nga Zyra e Prokurorit të Specializuar, nën dyshimet për pengim të drejtësisë. "Për të dyshuarin është lëshuar fletarrestim për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë, përkatësisht për frikësim të dëshmitarëve, hakmarrje dhe shkelje të fshehtësisë së procedurës", thuhej në njoftimin e këtyre dhomave.

Gjyqtari i procedurës paraprake, Nicolas Guillou, teksa ia lexoi të drejtat, i tha Haradinajt se ka të drejtë të kërkojë që të lirohet nga paraburgimi nëse brenda një viti ndaj tij nuk ngrehet aktakuzë. "Nuk janë ngritur ende akuza kundër të dyshuarit. Do të thotë, nuk është paraqitur ende aktakuzë nga prokurori i specializuar. Në këtë seancë nuk do të paraqiten dhe nuk do të debatohen prova", ka thënë gjyqtari Guillou.

Avokati i Haradinajt, Bes Martens, njoftoi se mbrojtja ka ngritur mocion për hedhjen poshtë të pretendimeve të Prokurorisë së Specializuar dhe mocion për lirimin e klientit të tij. "Mbrojtja ka dorëzuar një mocion për hedhjen poshtë të këtyre akuzave dhe lirimit të menjëhershëm të klientit tim. Prokuroria tha se po bëhet proces i shpejtë e se aktakuza po përpunohet shpejt, por unë s'kam dëgjuar një datë prej saj. Klienti im ka përfunduar në paraburgim. Kjo punë kërkon shumë javë dhe muaj. Duhet t'i rishikoni akuzat ndaj klientit tim. Ai s'është akuzuar për krime lufte. Ky është tribunal për krime lufte dhe klienti im s'është i akuzuar për krime lufte", ka thënë avokati mbrojtës i Nasim Haradinajt, Martens.

Zyrtarë të Dhomave të Specializuara gjatë seancës thanë se arrestimi i Haradinajt ishte i domosdoshëm sepse "rrethanat tregojnë se ekziston rreziku i arratisjes së tij, se ka motiv, mjete dhe mundësi për ta penguar ecurinë e procedurës" dhe se ai do ta përsëriste veprën penale të cilën dyshohet se e ka kryer.

Më 25 shtator është arrestuar edhe kreu i OVLUÇK-së, Hysni Gucati, i cili dyshohet për pengim të drejtësisë. Seanca e parë ndaj tij është caktuar të mbahet më 1 tetor. Gucati u arrestua në zyrat e kësaj organizate, pasi Zyra e Prokurorit të Specializuar kreu një aksion bastisjeje që zgjat më shumë se tetë orë.

Arrestimi i Haradinajt dhe Gucatit ndodhi pasi kjo organizatë të cilën ata e udhëheqin, tri herë radhazi mbajti konferenca për media ku shpërndanë materiale që pretendohet se janë dokumente konfidenciale të Gjykatës Speciale. Përmbajtja e këtyre dokumenteve është e panjohur dhe ende nuk është konfirmuar nëse ato janë autentike.

Zyra e Prokurorit të Specializuar me seli në Hagë njoftoi të enjten e kaluar se ka arrestuar nën dyshime për krime lufte, Salih Mustafën, njërin prej themeluesve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në zonën e Llapit. Ky ishte arrestimi i parë në Kosovë nga Zyra e Prokurorit të Specializuar. Ish-eprori i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Mustafa, gjatë paraqitjes së parë para Dhomave të Specializuara në Hagë të hënën, ka zgjedhur që të mos deklarohet rreth akuzave për krime lufte që rëndojnë ndaj tij.

## GUCATI MË 1 TETOR PARAQITET PARA SPECIALES

Të enjten, më 1 tetor, në orën 15:00, në sallën e gjyqit të Dhomave të Specializuara të Kosovës (DHSK) në Hagë, do të mbahet paraqitja e parë e kryetarit të OVLUÇK-së, Hysni Gucatit, i cili u arrestua më 25 shtator në Kosovë nga Zyra e Prokurorit të Specializuar në bazë të një fletarrestimi dhe urdhri për transferim, të lëshuara nga një gjykatës i Dhomave të Specializuara të Kosovës. Për të dyshuarin është lëshuar fletarrestim për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë, përkatësisht për frikësim të dëshmitarëve, hakmarrje dhe shkelje të fshehtësisë së procedurës, të parapara në Kodin Penal të Kosovës, sikurse përfshihen në nenin 15(2) të Ligjit nr. 05/L-53 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar. "Paraqitja e parë e Hysni Gucatit do të mbahet në seancë publike, e cila mund të përcillet përmes transmetimit në internet. Gjithashtu, DHSK-ja ka një qendër të posaçme për median, nga e cila gazetarët mund të punojnë dhe përcjellin seancat me një vonesë të shkurtër. Për shkak të masave për ta parandaluar përhapjen e Covid-19, numri i uleseve në galerinë publike dhe në qendrën për median do të jetë shumë i kufizuar dhe regjistrimi paraprak është i nevojshëm", është thënë në njoftimin e Gjykatës Speciale.



Analistët politikë hedhin poshtë pretendimet e kryeministrit Avdullah Hoti se qeveria është stabile

# ANALISTËT: QEVERIA ËSHTË E BRISHTË, GJASAT QË TË STABILIZOHET JANË ZERO

Njohësit e rrethanave politike në vend kanë bërë me dije se qeveria Hoti nuk i ka numrat e nevojshëm për ta qeverisur vendin. Imer Mushkolaj dhe Faton Abdullahu kanë deklaruar për gazetën "Epoka e re" se vazhdimi i punës së kësaj qeverie e cila nuk mund t'i kalojë ligjet e nevojshme në Kuvend do të krijojë dëme për vendin dhe qytetarët. Ata kanë vlerësuar se moskalimi i Projektligjit për rimëkëmbjen ekonomike për të pestën herë me radhë tregon për mosfunksionalitetin e këtij koalicioni qeverisës. Sipas tyre, rruga më e mirë për të dalë nga kjo situatë janë zgjedhjet e reja

EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 29 SHTATOR- Kryeministri Avdullah Hoti po pretendon se koalicioni qeverisës është stabil, por krejt ndryshe mendojnë njohësit e rrethanave politike. Ata kanë vlerësuar se vetë fakti se kjo qeveri nuk mund t'i kalojë as ligjet me shumicë të thjeshtë në Kuvend tregon për stabilitetin e këtij koalicioni qeverisës. Sipas tyre, vazhdimi i kësaj mënyre të qeverisjes është i dëmshëm për vendin dhe qytetarët.

Analisti politik Imer Mushkolaj ka thënë për "Epokën e re" se një qeveri e cila nuk i ka numrat për kalimin e ligjeve në Kuvend duhet të dorëhiqet. "Ajo që thotë kryeministri Hoti është në kontradiktë me gjendjen reale. Në një situatë kur një qeveri nuk mund ta kalojë një ligj të rëndomtë me shumicën e thjeshtë në Kuvend, nuk ka çfarë kërkon më në qeverisje. Është dashur të tërhiqet. Në rastin tonë, kur pesë herë qeveria nuk mund ta kalojë një ligje në Kuvend, kjo e kalon çdo logjikë normale të funksionimit të një qeverie", ka thënë Mushkolaj.

Ai ka bërë me dije se pas dorëzimit të deputetit Etem Arifi tek organet e drejtësisë për ta vuajtur dënimin, qeveria nuk i ka numrat e nevojshëm. "Në anën tjetër, tash e dimë se me rastin e deputetit Arifi, në fakt koalicioni nuk i ka as votat me të cilat është zgjedhur, gjë që është shumë problematike. Nuk po them se nuk mund të vazhdojë qeverisjen në këtë mënyrë, sepse gjithçka varet edhe nga opozita", është shprehur Mushkolaj. Sipas tij, vazhdimi i punës së këtij koalicioni në këtë mënyrë do të jetë në dëm të qytetarëve të Kosovës. "Në anën tjetër, opozitën e kemi jounike,



sepse dy partitë nuk po bëhen bashkë për ta ngritur mocionin e mosbesimit. Dhe nëse ngrehet mocioni, atëherë do të duhej të fokusoheshin edhe në gjetjen e ndonjë vote shtesë në mënyrë që t'i sigurojnë votat e nevojshme për rrëzimin e qeverisë. Por, është jashtëzakonisht e dëmshme të funksionojë një qeveri e tillë e cila nuk mund ta kalojë një ligj i cili është në të mirën e qytetarëve. Duke pasur parasysh deklarimin e LV-së dhe të PDK-së se kjo qeveri është e dëmshme dhe e rrezikshme, atëherë cila është logjika që ata nuk po e heqin këtë qeveri të dëmshme", ka deklaruar Mushkolaj, duke treguar se pse kjo qeveri është e dëmshme. "Edhe unë besoj se kjo qeveri është e dëmshme, sepse ende nuk ka arritur ta kalojë në Kuvend Projektligjin për rimëkëmbje ekonomike, pas pesë dështimeve, kurse shtetet fqinje, siç është rasti i Maqedonisë, ka miratuar edhe pakon e katërt të mbështetjes për bizneset dhe qytetarët", është shprehur ai.

Edhe analisti tjetër politik Faton Abdullahu mendon se kjo qeveri është e dëmshme për vendin.

Ai ka thënë për gazetën "Epoka e re" se qeveria Hoti nuk është as normale e as stabile. "Nëse në mungesë të votave, në këtë kohë pandemie nuk mund të ndihmohet qytetari me paratë e premtuara për ta kaluar pak më mirë këtë situatë që e ka dëmtuar kualitetin e jetës së tij edhe ashtu jo të mirë, kjo qeveri nuk mund të jetë as normale, as stabile e më së paku funksionale. Për LDK-në më e rëndësishmja ka qenë që ta rrëzojë qeverinë Kurti duke e akuzuar si antiamerikane me qëllim që ta krijojë perceptimin se ajo është më pro-amerikane e nuk ka dashur të kuptojë se ajo po servonte një qeverisje anti-qytetare", ka thënë Abdullahu. Sipas tij, funksionimi në këtë mënyrë i qeverisë është në dëm të qytetarëve dhe të vendit. "Kjo qeveri është e brishtë dhe gjasat që ajo të stabilizohet dhe të jetë funksionale janë zero. Përderisa është kështu çdo ditë që po rrjedh me këtë lloj qeverisje shkon në dëm të qytetarit të Kosovës, por edhe në dëm të Kosovës, sidomos në raport me dialogun me Serbinë. Kjo qeveri pretendon se e ka nxjerrë më të mirën në Uashington. Kjo nuk qëndron", ka thënë ai, duke shtuar se qeveria Hoti të metat e saj po përpiqet t'i fshehë përmes dialogut të Brukselit. "Për më keq, ajo po përpiqet pandalshëm që atë që nuk e ka në Kosovë, atë që i mungon këtu, ta kompensojë me faktorizim në Bruksel dhe Uashington. Të metat dhe mangësitë e kësaj qeverie brenda nuk mund të eklipsohen me pretendimet se jashtë, në Uashington, ajo ka arritur sukses të madh. E brishtë e përçarë me shumicë shqiptare jashtë, pa ekspertë dhe pa guxim, ajo në Uashington nuk e nxori më të mirën e mundshme", ka thënë ai.

### Zgjedhjet, rruga më e mirë

Analistët politikë kanë vlerësuar se kjo gjendje nuk mund të vazhdojë më kështu. Sipas tyre, opozita duhet të bashkohet dhe ta çojë vendin drejt zgjedhjeve të reja. "Më së miri është të shkojmë në zgjedhje. Kanë ndryshuar shumë gjëra dhe nuk mund të bazohemi më në vullnetin politik të 6 tetorit të vitit të kaluar. Ta kemi edhe një konfigurim të kësaj qeverie duke u bazuar në votat e 6 tetorit të vitit të kaluar do të thotë të kemi tri qeveri nga një palë zgjedhje, nga një vullnet politik, qeverinë Kurti, qeverinë Hoti dhe një të re me konfigurim", ka thënë analisti Faton Abdullahu, duke shtuar se ka ardhur koha që të vijë në shprehje vullneti i qytetarëve. "Jo duhet edhe një herë ta lexojmë me zgjedhje vullnetin politik të qytetarit sepse shumë gjëra kanë ndryshuar. Thjesht. më mirë është të shkojmë në zgjedhje kur këtë na lejon situata e pandemisë. Nëse kjo nuk është e mundshme, në rast të përkeqësimit të situatës së pandemisë, atëherë ka sens rikonfigurimi dhe vetëm për një periudhë të shkurtër kohore", është shprehur ai.

Kurse analisti Imer Mushkolaj ka thënë se shkuarja në zgjedhje apo jo është në duar të PDK-së. Sipas tij, tani çdo gjë varet nga partia e Kadri Veselit. "Gjithçka varet nga PDK-ja. Kjo parti tani është në një pozicion as mish e as peshk siç thuhet, sepse as nuk po futet në qeveri që t'ia zgjasë jetën kësaj qeverie të paktën deri në një moment tjetër, e as nuk po bëhet bashkë me LV-në për ta votuar mocionin për rrëzimin e qeverisë. Pra, gjithçka varet nga PDK-ja dhe çfarëdo që ndodh është rezultat i kontributit ose jo të PDK-së, qoftë në versionin e parë, qoftë në versionin e dytë", ka thënë Mushkolaj.

Edhe opozita mendon se qeveria aktuale nuk i ka votat e mjaftueshme për ta qeverisur vendin.

Përfaqësuesit e PDK-së dhe të LV-së kanë vlerësuar se qeveri Hoti nuk është në shërbim të qytetarëve të vendit. Lideri i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, qeverinë aktuale e ka vlerësuar si qeveri të lodhur.

Kurse ish-ministrja e Drejtësisë dhe zyrtarja e lartë e Lëvizjes Vetëvendosje, Albulena Haxhiu, ka thënë se për kryeministrin është e rëndësishme vetëm ulësja. Ajo ka thënë se kjo qeveri nuk i ka numrat për asnjë çështje për ta shtyrë përpara.

Pavarësisht prej pretendimeve të analistëve politikë dhe opozitës, kryeministri Avdullah Hoti mendon se koalicioni të cilin e udhëheq ai është stabil dhe nuk ka nevojë për zgjerim. "Koalicioni qeverisës është duke funksionuar. Qeveria është stabile dhe për aq kohë sa është qeveria stabile unë nuk shoh arsye që të hyjmë në kombinime të tjera. Jemi duke respektuar marrëveshjen e koalicionit, jam duke u kujdesur çdo ditë që të respektohet kjo marrëveshje", ka thënë Hoti.

Koalicioni aktual qeverisës në Kosovë përbëhet nga Lidhja Demokratike e Kosovës, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Nisma Socialdemokrate dhe partitë e pakicave.

# Stano: Puna për dialogun Kosovë - Serbi vazhdon

**Prishtinë, 29 shtator** - Puna në kuadër të dialogut midis Kosovës dhe Serbisë është në vazhdim e sipër në Bruksel, edhe pse takimet që janë planifikuar për këtë javë nuk janë mbajtur. Kështu ka thënë Peter Stano, zëdhënës i BE-së për politikë të jashtme. Ai ka paralajmëruar se, sapo të ketë ndonjë datë për takimin e radhës Kosovë - Serbi, do ta bëjë të njohur edhe për publikun.

Stano nuk ka dha ndonjë përgjigje të saktë rreth temës së krijimit të asociacionit të komunave me shumicë serbe në Kosovë, i cili thuhet të jetë bërë edhe shkak për moszhvillimin e takimeve midis Kosovës dhe Serbisë, pasi Kosova nuk dëshiron të diskutohet më për këtë temë, ndërsa Serbia insiston që ajo të trajtohet me prioritet.

Stano para disa ditësh ka thënë se Kosova e ka obligim për të krijuar asociacionin e komunave me shumicë serbe sipas marrëveshjeve të vitit 2013 dhe 2015 dhe se Prishtina duhet të vijë me propozim se si të zbatohet kjo pjesë e marrëveshjeve. Por, në pyetjen se a duhet të krijohet asociacioni sipas ligjeve të Kosovës dhe në bazë të vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, ai nuk dha përgjigje të qartë, duke thënë se "rreth kësaj nuk ka asgjë të re për të shtuar".

Autoritetet e Kosovës kanë thënë se "gjithçka do të jetë sipas Kushtetutës së Kosovës" kur janë shprehur për krijimin e asociacionit.

Edhe qeveria gjermane, përmes zëdhënësit të saj, Steffen Seibert, ka thënë se ky asociacion duhet të krijohet sipas ligjeve të Kosovës. Por, në Serbi nuk janë të interesuar për një gjë të tillë.

Gjatë qëndrimit të tij të fundit në Bruksel, shefi i delegacionit të Serbisë për dialog me Kosovën, Marko Gjuriq, ka thënë se "e ashtuquajtura Gjykatë Kushtetuese e Kosovës është përdorur për ta bllokuar krijimin e bashkësisë së komunave serbe" dhe ka shtuar se "edhe Serbia e ka Kushtetutën e saj".

Formimi i asociacionit të komunave me shumicë serbe në Kosovë është paraparë me Marrëveshjen e Brukselit të vitit 2013 të arritur në dialogun Kosovë - Serbi. Në vitin 2015, dy vendet, nën ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, kanë arritur edhe një marrëveshje shtesë për themelimin e këtij asociacioni. Por, Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka konstatuar se parimet për të nuk janë në përputhje me Kushtetutën e Kosovës, edhe pse ka thënë se ato mund të harmonizohen me një akt ligjor të Qeverisë së Kosovës.

Masat lidhur me parandalimin e përhapjes së koronavirusit kanë bërë që të hënën të mos zhvillohet një takim mes koordinatorëve të Kosovës dhe Serbisë në Bruksel.

Por, edhe po të zhvillohej, në të nuk do të diskutohej për asociacionin pasi, siç ka konfirmuar edhe i dërguari i posaçëm i BE-së për dialogun, Miroslav Lajčák, "njëra palë ende nuk është e gatshme për këtë". Pala e Kosovës nuk e ka fshehur se ajo është kundër diskutimeve për këtë temë.






Kadri Veseli ka mbajtur konferencë për media në të cilën ka folur për suksesin e komunave që udhëhiqen nga PDK-ja

# Veseli thotë se PDK-ja do të rikthehet fuqishëm në zgjedhjet lokale

Kryetari i Partisë Demokratike i Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka bërë me dije të martën se zgjedhjet lokale që po vijnë, shënojnë vitin e madh të kthimit të PDK-së në pushtetet komunale. Në konferencën për media, ku ishte i shoqëruar edhe nga kryetari i Drenasit, Ramiz Lladrovci, Veseli ka theksuar se modeli i qeverisjes së suksesshme të komunave të udhëhequra nga PDK-ja është tregues i qartë se vota e dhënë nga qytetarët në këto komuna është shpërblyer me punë

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 29 SHTATOR - Kryetari i Partisë Demokratike i Kosovës (PDK), Kadri Veseli, i shoqëruar nga kryetari i Drenasit, Ramiz Lladrovci, kanë mbajtur të martën një konferencë për media. Në këtë konferencë, Veseli ka folur për suksesin që kanë shënuar komunat e qeverisura nga PDK-ja në nivel të Kosovës dhe me performancën e lartë që kanë arritur. Në raportin e publikuar për performancën e komunave në gusht të këtij viti nga Ministria e Pushtetit Lokal, rezulton se nga 37 komuna të Kosovës, në top 10 për performancën më të mirë janë tri komuna të qeverisura nga PDK-ja. "Modeli i qeverisjes së suksesshme të komunave të udhëhequra nga PDK-ja është tregues i qartë se vota e dhënë nga qytetarët në këto komuna është shpërblyer me punë, me shërbime të mira për ta dhe pa asnjë abuzim. Ky është vizioni ynë, për mirëqeverisje, transparencë dhe pa korrupsion", ka thënë Veseli.

Po ashtu, ai ka theksuar se performanca e lartë e komunave të udhëhequra nga PDK-ja në raport me komunat e qeverisura prej partive të tjera, tregon qartë dallimin e madh. "Këto parti bëjnë premtime e mashtrime ndaj qytetarëve dhe nuk janë në gjendje të bëjnë as edhe një punë të mirë. Ftoj qytetarët e Kosovës që t'i besojnë PDK-së, t'i besojnë vizionit të saj dhe përfaqësuesve të saj në komuna gjatë zgjedhjeve lokale që do të mbahen vitin e ardhshëm. Jam i bindur se modelet e qeverisjes së suksesshme në Drenas, Ferizaj, Kaçanik e Shtime do të mbështeten nga qytetarët edhe në komunat e tjera të Kosovës. Sepse ky është modeli i premtimeve që mbahen e kthehen me punë, dhe jo i mashtrimit e keqqeverisjes", ka deklaruar Veseli.

Ai ka bërë me dije se brenda disa javëve Partia Demokratike e Kosovës do të fillojë t'i shpallë kandidaturat për kryetarë të komunave dhe ekipet e tyre. "Oferta qeverisëse është rezultat i kërkesave dhe nevojave të drejtpërdrejta të qytetarëve. Jam i bindur se këto zgjedhje lokale që po vijnë, shënojnë vitin e madh të kthimit të PDK-së në pushtetet komunale", është shprehur kryetari i PDK-së, Kadri Veseli.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka falënderuar Veselin për besimin dhe është shprehur i lumtur që këtë po ia shpërblen me rezultat të suksesshëm. Komuna e Drenasit, nën udhëheqjen e Ramiz Lladrovcit, është e para edhe këtë vit për performancë të mirë, e pasuar në vendin e shtatë nga Komuna e Kaçanikut, me udhëheqjen e kryetarit Besim Ilazi, e në vendin e tetë ajo e Ferizajt e udhëhequr nga Agim Aliu.

# Cakaj takon homologun gjerman: Theksuam nevojën e liberalizimit të vizave për Kosovën



TIRANË, 29 SHTATOR (ER) - Ministri i Jashtëm në detyrë i Shqipërisë, Gent Cakaj, ka takuar homologun gjerman Michael Roth, me të cilin ka biseduar për punën e Shqipërisë drejt mbajtjes së Konferencës së Parë Ndërqeveritare. Gjithashtu, Cakaj ka bërë me dije se kanë diskutuar hollësisht për procesin e reformës zgjedhore, luftën kundër krimit dhe korrupsionit, plotësimin e zbrazësive në Gjykatën e Lartë dhe Gjykatën Kushtetuese, si dhe ngritjen e SPAK dhe BKH. "Ekziston një fakt i njohur nga të gjithë: Shqipëria ka bërë përparim madhor në pesë prioritetet kyçe dhe gëzon të gjitha kapacitetet e nevojshme për të rrugëtuar më tej drejt anëtarësimit në BE", ka thënë ai.

Ministri Cakaj ka thënë se në këtë takim theksuan fuqishëm nevojën e menjëhershme të liberalizimit të vizave për Republikën e Kosovës sepse, sipas tij, Kosova jo vetëm se i ka plotësuar kushtet teknike, por ka bërë më shumë se çdo vend tjetër në rajon për ta fituar mundësinë e lëvizjes së lirë në hapësirën e familjes evropiane.

# Mbi 13 000 pacientë në Kosovë të shëruar nga Covid-19

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar të martën se gjatë 24 orëve të fundit nuk është regjistruar asnjë vdekje nga Covid-19. Sipas IKShPK-së, gjatë 24 orëve janë testuar 670 mostra dhe, bazuar në rezultatet laboratorike, janë regjistruar edhe 54 persona të infektuar me koronavirus. Deri më sot mbi 13 000 pacientë në Kosovë janë shëruar nga ky virus

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 29 SHTATOR - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe laboratorët privatë, me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 670 mostra të marra nga ShSKUK-ja dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 54 raste pozitive me Covid-19.

Brenda 24 orëve nuk është raportuar asnjë rast i vdekjes me Covid. Numri total i rasteve pozitive është 15 574 raste nga 67 294 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 625 raste të vdekjes.

Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 72 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 13 492 raste, ndërsa numri i rasteve aktive është 1 457.

Rastet pozitive janë nga: komuna Prishtinë 26 raste, komuna Ferizaj 8 raste, komuna Lipjan 4 raste, komuna Vushtrri 4 raste, komuna Gjilan 3 raste, komuna Fushë Kosovë 2 raste, komuna Skenderaj 2 raste, dhe me nga një rast Drenas, Obiliq, Pejë, Podujevë dhe Shtime.

Ndërsa Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK) ka njoftuar se në institucionet publike shëndetësore në Kosovë aktualisht janë të shtrirë 175 pacientë, prej tyre 103 janë të infektuar me koronavirus dhe po trajtohen në klinika dhe spitale.

Në raportin ditor të ShSKUK-së është thënë se gjashtë pacientë janë në respiratorë, 6 janë duke u trajtuar me makinat e frymëmarrjes CPAP, ndërsa 102 të tjerë janë me oksigjenoterapi.

## Zemaj: Kosova po menaxhon pandeminë më mirë se vendet e rajonit

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka thënë se Kosova është më mirë se vendet e rajonit sa i përket menaxhimit të pandemisë. Në profilin e vet në "Facebook", ai ka shkruar se këtë fakt ua ka prezantuar gjatë një takimi virtual, edhe donatorëve dhe partnerëve ndërkombëtarë. "Kosova është më mirë se vendet e rajonit e madje edhe më mirë se vendet me sistem shëndetësor më të avancuar sa i përket menaxhimit të pandemisë. Këtë ua thashë edhe donatorëve dhe partnerëve ndërkombëtarë në takimin e rregullt javor të mbajtur në mënyrë virtuale", ka thënë ai.

Ministri Zemaj ka pohuar se Kosova dhe Ministria e Shëndetësisë janë me fat që kanë partnerë ndërkombëtarë që po ndihmojnë vendin tonë në luftën kundër Covid-19.




## Pas hapjes së zyrës, Hoti pret në takim përfaqësuesit politikë të Luginës

PRISHTINË, 29 SHTATOR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka pritur të martën në takim përfaqësuesit politikë të Luginës së Preshevës, me të cilët ka biseduar rreth aktualitetit politik dhe ekonomik në vend, për sfidat në luftën kundër Covid-19 si dhe për gjendjen e shqiptarëve në Luginë. Po ashtu, kryeministri Hoti ka theksuar se qeveria ka miratuar vendimin për themelimin e "Zyrës për ofrimin e asistencës për qytetarët e Luginës së Preshevës", në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, e cila do të angazhohet t'i ndërmarrë masat e nevojshme që ta lehtësojë dhe përmirësojë jetën e qytetarëve që jetojnë në atë anë, me theks të veçantë në fushën e arsimit, kulturës dhe ekonomisë. "Zyra do të trajtojë edhe çështje të tjera që nuk janë listuar në këtë vendim, por që dalin si kërkesa dhe nevoja eventuale nga qytetarët që jetojnë në Luginën e Preshevës", ka thënë Hoti.

Nga ana e tyre, përfaqësuesit e Luginës së Preshevës e kanë falënderuar kryeministrin Hoti për pritjen, veçanërisht për themelimin e zyrës për ofrimin e asistencës për qytetarët e Luginës së Preshevës, duke shtuar se shtimi i bashkëpunimit është në dobi të dyanshme.



# BQK-ja dhe MASh nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi për tekstet e edukimit financiare



PRISHTINË, 29 SHTATOR (ER) - Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Fehmi Mehmeti dhe ministri i Arsimit dhe Shkencës, Ramë Likaj, kanë nënshkruar memorandumin e mirëkuptimit për ta institucionalizuar përfshirjen e pesë teksteve të edukimit financiar në kurrikulën shkollore. Me këtë rast, guvernatori Mehmeti ka thënë se BQK-ja është e angazhuar për nxitjen dhe ruajtjen e stabilitetit financiar në vend dhe se sektori financiar është një ndër kontribuuesit kryesor në ekonominë e Kosovës.

Ai ka theksuar se BQK-ja rëndësi të veçantë i kushton edhe edukimit financiar për të cilin ka punuar dhe ka investuar për ta avancuar për shumë vite. "Projekti i koleksionit të pesë librave, projekt i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe i përkrahur nga Departamenti për Zhvillim i Fondit Evropian për Evropën Juglindore, EFSE DF, ka për qëllim që t'i pajisë nxënësit e shkollave fillore me koncepte bazike financiare, të cilat do t'i përcjellin gjatë tërë jetës së tyre pa marrë parasysh profesionin që ata do ta përzgjedhin në të ardhmen. Tekstet janë përgatitur nga ekspertë përkatës të fushës, tekstshkrues dhe ilustratorë, në pajtueshmëri me kurrikulën bërthamë për arsimin fillor të Kosovës", ka thënë ai.

Mehmeti ka pohuar se koleksioni përbëhet nga pesë libra me tregime për fëmijë të moshave 6-10 vjeç, përkatësisht për nxënësit e klasave I-V të arsimit fillor. "Fokusi i librave është edukimi financiar, me ç'rast fëmijët kanë mundësi të mësojnë në lidhje me tema financiare bazike të përzgjedhura për moshat përkatëse, gjithmonë bazuar në standardet e rekomanduara nga OECD. Përveç formës së shkruar, librat janë përgatitur dhe me zë (audio), në mënyrë që të jenë të përshtatshme edhe për fëmijët e verbër apo me të pamë të dobësuar dhe, përveç gjuhës shqipe, janë të përkthyera edhe në gjuhë të tjera siç është përcaktuar me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve", ka thënë guvernatori Mehmeti.

Librat do të shpërndahen në formë fizike nëpër shkollat fillore të të gjitha komunave të Kosovës, në formë elektronike përmes kanaleve të komunikimit të BQK-së dhe me Shoqatën/Shkollën e të Verbërve të Kosovës. Mehmeti ka falënderuar ministrin Likaj dhe Fondin për Evropën Juglindore (Finance in Motion-EFSE), Zyrën në Kosovë, për bashkëpunimin për realizimin e këtij projekti.

Ndërsa ministri Likaj ka shprehur përkushtimin e tij që bashkëpunimi me BQK-në në të mirë të edukimit financiar të nxënësve të vazhdojë edhe në të ardhmen. "Ministria e Arsimit dhe e Shkencës është e interesuar që ta ngrehë nivelin arsimor sa i përket edukimit financiar dhe konsiderojmë shumë të rëndësishëm që të procedojmë tutje, në këtë aspekt që fëmijët të mund të marrin njohuri dhe të përgatiten dhe të kenë vetëdijesim se si duhet shpenzuar dhe menaxhuar paranë. Nxënësve do t'u shpërndahen libra në këtë vit nga klasa 1-5 në tërë territorin e Kosovës mbi 900 shkolla dhe, përveç gjuhës shqipe, tekstet do të jenë edhe në gjuhë të komuniteteve. Tekstet janë në përputhje me kurrikulat e sistemit tonë arsimor dhe janë të përgatitura nga njohës të fushave, andaj Ministria e Arsimit dhe e Shkencës do të jetë përherë në kontakt me shkollat dhe drejtoritë komunale të arsimit që t'i marrim rezultatet se si do të ndikojnë këto tekste te nxënësit tanë", ka thënë ministri Likaj.

Christoph Tiskens, kryetar i Bordit të Drejtorëve të EFSE, në fjalën e tij hapëse ka theksuar rëndësinë e realizimit të këtij projekti si dhe ka shprehur gatishmërinë për të punuar në projektet e ardhshme.

# Banka Botërore: Pandemia do të varfërojë miliona njerëz




UASHINGTON, 29 SHTATOR - Banka Botërore paralajmëroi se pandemia e koronavirusit mund t'i varfërojë 38 milionë njerëz në Azinë Lindore dhe në Paqësor. Pa veprime të shpejta të qeverive, "goditja e trefishtë" nga virusi, nga masat e izolimit dhe nga recesioni global mund të shkaktojë dëme për vitet që vijnë, tha Banka Botërore. Sipas saj, sëmundja, pasiguria ushqimore, humbja e vendeve të punës dhe mbyllja e shkollave "mund të çojnë në keqësim të kapitalit njerëzor dhe në humbje të të ardhurave që zgjasin gjithë jetën".

Paralajmërimi vjen pasi varfëria, sipas Bankës Botërore, ka pësuar rënie dramatike në pjesën më të madhe të Azisë Lindore gjatë dy dekadave të fundit. Banka Botërore e cilëson të varfër secilin që jeton me më pak se 5.50 dollarë në ditë.

Në muajin maj Banka Botërore ka paralajmëruar se rritja globale mund të tkurret me 5 për qind si pasojë e pandemisë së koronavirusit. Ajo, po ashtu, ka thënë se deri në 60 milionë njerëz në të gjithë botën mund të futen në varfëri ekstreme, që do të thotë të jetosh me më pak se 1.90 dollar në ditë.

Organizata Botërore e Shëndetësisë e ka shpallur pandemi sëmundjen që e shkakton koronavirusi, Covid-19, në muajin mars. Në të gjithë botën, koronavirusi ka prekur mbi 33 milionë njerëz. Prej tyre, mbi një milion kanë vdekur dhe mbi 23 milionë janë shëruar.

# Kryeministri Hoti: Do ta subvencionojmë dhe mbështesim prodhimin vendor



Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka shprehur përkushtimin e qeverisë për të qenë afër fermerëve dhe përpunuesve të qumështit, për ta përmirësuar situatën me të cilën po përballet ky sektor. Gjatë takimit me përfaqësuesit e sektorit të qumështit, nga të cilët është njoftuar për sfidat me të cilat po përballen ata, kryesisht për shkak të situatës së krijuar nga pandemia Covid-19, Hoti ka bërë me dije se do ta mbështesin prodhimin vendor

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 29 SHTATOR - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, bashkë me ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Besian Mustafa, ministrin e Tregtisë, Vesel Krasniqi dhe drejtorin e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, Naser Krasniqi, ka pritur përfaqësuesit e sektorit të qumështit, nga të cilët është njoftuar për sfidat me të cilat po përballen ata, kryesisht për shkak të situatës së krijuar nga pandemia Covid-19. Me këtë rast, kryeministri Hoti ka shprehur përkushtimin e qeverisë për të qenë afër fermerëve dhe përpunuesve të qumështit, për ta përmirësuar situatën me të cilën po përballet ky sektor.

Në këtë takim është arrtiur marrëveshja që qeveria të marrë përsipër në kuadër të Pakos për rimëkëmbje ekonomike të subvencionojë prodhimin vendor, përfshirë edhe prodhimin e qumështit në vlerë prej 25 përqindësh të çmimit të qumështit dhe produkteve të qumështit që është në stok. "Do ta subvencionojmë vetëm qumështin dhe produktet e qumështit, jo produktet që kanë substanca të tjera si, për shembull, qumësht pluhur ose me bazë me vaj palme", ka thënë Hoti. Pas takimit, kryeministri Hoti në një konferencë për media tha se ky sektor është zinxhir, duke filluar nga blegtorët te grumbulluesit e qumështit, pastaj te përpunuesit dhe në fund marketet - tregu. Siç tha kryeministri, problemi qëndron te hallka e tretë, përpunuesit dhe disa probleme te hallka e katër, marketet.

Më tej, kryeministri Hoti tha se do të ketë kontroll rigoroz të importit të vajit të palmës dhe importit të qumështit pluhur, që të dihet se cilët përpunues të qumështit janë duke importuar dhe si po i përdorin këto produkte për shkak se qeveria është e interesuar që ta mbështesë prodhimin vendor, pra blegtorët. Ndër të tjera, kryeministri Hoti tha se në tregtinë e brendshme Inspektorati i Tregut bashkë me AVUK-un do të jenë jashtëzakonisht aktivë për t'u siguruar që në market të ndahen fizikisht në lokacione të ndryshme brenda marketit produktet që janë me vaj palme dhe produktet që kanë bazë qumështin dhe ato të jenë të shënuara në mënyrë adekuate, që konsumatorët ta identifikojnë lehtë produktin dhe të dinë se çfarë blejnë.

Po ashtu, kryeministri Hoti ka theksuar se kanë marrë obligim që të punojnë bashkë me Ministrinë e Financave dhe me Administratën Tatimore të Kosovës që të përgatitet e gjithë baza ligjore, rregulloret, udhëzimet e ndryshme në mënyrë që të njihen humbjet në rast se derdhet qumështi apo hedhen produktet e ndryshme të qumështit. "Këto janë pajtimet që kemi marrë sot me sektorin e qumështit, që mbulon mbi 90 për qind të këtij sektori. Dhe ne do t'i kontaktojmë edhe prodhuesit e tjerë në mënyrë që bashkë me ministrat t'i marrim hapat e nevojshëm dhe t'i sjellim vendimet në qeveri sa më parë në mënyrë që t'u dalim në ndihmë", ka thënë kryeministri Hoti, duke shtuar se kjo zgjidhje duhet të jetë e pranueshme për të gjithë. "Është paralajmëruar që disa prodhues, disa grumbullues të qumështit të dalin sot në protestë. Unë u bëj thirrje atyre, i lus që të mos e hedhin qumështin, sepse ju e dini se për çdo litër të qumështit që prodhohet, ne deri më tash e kemi subvencionuar 6 centë, 4 centë dhe 2 centë për litër, ndërsa tash e kemi dyfishuar me vendimin e djeshëm në qeveri, subvencionojmë 12 centë, 8 centë dhe 4 centë për litër, varësisht prej cilësisë së qumështit dhe në të njëjtën kohë e kemi rritur subvencionimin për krerë të gjedheve, nga 70 euro në 140 euro, ndërsa për bagëtitë e imta nga 15 euro në 30 euro", është shprehur Hoti. Gjithashtu, ai premtoi se qeveria do t'i kryejë të gjitha detyrat që i takojnë, për t'u dalë në ndihmë në forma të ndryshme përmes subvencionimit të qumështit, të stoqeve që kanë mbetur të pashitura dhe përmes granteve.

## 'Ndërmarrjet publike duhet të kenë menaxhim të mirëfilltë profesional'

PRISHTINË, 29 SHTATOR - Kryeministri Avdullah Hoti, i shoqëruar nga ministri i Ekonomisë dhe Ambientit, Blerim Kuçi, ka pritur sot përfaqësuesit e Ndërmarrjes Hidroekonomike "Ibër - Lepenc", Sh.A. dhe Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit "Prishtina" Sh. A., me të cilët ka biseduar për sfidat me të cilat po përballen këto ndërmarrje, si dhe për aspektet zhvillimore të tyre. Me këtë rast, kryeministri Hoti ka theksuar nevojën që të gjitha ndërmarrjet publike në Republikën e Kosovës, veçanërisht ato me rëndësi strategjike për vendin, siç janë "Ibër - Lepenc" dhe "Prishtina", duhet të kenë menaxhim të mirëfilltë profesional në funksion të rritjes së performancës, efikasitetit dhe maksimizimit të të hyrave.

Hoti ka thënë se Qeveria e Kosovës është duke punuar me përkushtim për rimëkëmbjen ekonomike si pasojë e pandemisë Covid-19. Njëkohësisht, ai vlerësoi se duhet përkushtim i të gjithëve pa përjashtim për përballimin e kësaj situate dhe menaxhimin sa më efikas për përmbushjen e objektivave të përcaktuara.



Ndërsa përfaqësuesit e N. P. H. "Ibër - Lepenc" Sh.A. dhe KRU "Prishtina" e falënderuan kryeministrin Hoti për pritjen si dhe e njoftuan atë për punët që janë duke u kryer në këto ndërmarrje, me qëllim të arritjes së synimeve për zgjerimin dhe ngritjen e kapaciteteve të tyre.

# Në mungesë të kuorumit dështon seanca për aprovimin e draftbuxhetit komunal të Mitrovicës për vitin 2021

Mitrovicë, 29 shtator (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka thirrur mbledhje urgjente të Kuvendit Komunal, ku pikë e vetme e rendit të ditës ishte aprovimi i draftbuxhetit komunal për vitin 2021 dhe parashikimet për vitet 2022-2023. Në këtë seancë ishin të pranishëm asamblistët nga radhët e Vetëvendosjes, të Nismës dhe të AAK-së, ndërkaq kjo mbledhje është bojkotuar nga asamblistët e LDK-së, PDK-së, PD-së dhe AKR-së.

Në fjalën e tij kryetari i komunës, Agim Bahtiri, ka thënë se ndien keqardhje për mospraninë e opozitës në këtë mbledhje sepse, sipas tij, buxheti është hartuar duke respektuar dispozitat ligjore dhe duke marrë për bazë kërkesat dhe sugjerimet e qytetarëve të dhëna në diskutimet publike, ku përveç kësaj u është dhënë mundësia edhe partive politike ta japin kontributin e tyre për harmonizimin e këtij buxheti, i cili u destinohet të gjithë qytetarëve të Mitrovicës. "Ne si ekzekutiv kemi qenë çdoherë të hapur për bashkëpunim me të gjitha partitë politike dhe në mbledhjen e fundit të Kuvendit e kam pezulluar aprovimin e buxhetit me kërkesë të opozitës për hartim të përbashkët, ku në takimin e djeshëm ka marrë pjesë vetëm përfaqësuesi i partisë LDK dhe, pavarësisht prej përpjekjeve të mia, opozita për interesa



politike e bojkotoi këtë seancë. Andaj mua nuk më mbetet zgjidhje tjetër, veçse t'u drejtohem organeve kompetente për fillimin e procedurave për shpalljen e zgjedhjeve të Asamblesë Komunale", ka thënë kryetari Bahtiri.

# Buxheti i Malishevës për vitin 2021 do të jetë rreth 15 milionë euro



Malishevë, 29 shtator (ER) - Kuvendi i Komunës së Malishevës të martën ka mbajtur vazhdimin e mbledhjes së rregullt, me pikën e vetme të rendit të ditës, shqyrtimin e dytë të projektbuxhetit për vitin 2021, i cili është miratuar me shumicën e votave të anëtarëve të këtij kuvendi.

Buxheti i propozuar nga kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, është 14 milionë e 900 mijë e 757 euro dhe është i shpërndarë sipas kategorive: paga dhe mëditje 8 363 200 euro, mallra dhe shërbime 1 529 526 euro, shpenzime komunale 455 mijë euro, subvencione 400 mijë dhe investime kapitale 4 153 031 euro.

# Javën e ardhshme KEDS-i fillon realizimin e projekteve në Suharekë

Suharekë, 29 shtator (ER) - Kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, ka pritur në takim drejtorin për investime në KEDS, Hasan Oz, me të cilin janë pajtuar për fillimin e projekteve investuese në këtë komunë. Ai ka thënë se e ka falënderuar zyrtarin e KEDS-it për vizitën dhe angazhimin e tij, duke bërë me dije se ka marrë premtime që javën e ardhshme do të fillojnë punimet për shtrirjen e rrjetit nëntokësor në sheshin e qytetit. "Kam kërkuar që të respektohet koha e fillimit të punimeve, të punohet mirë dhe me cilësi në rrjetin nëntokësor elektrik, pasi është fjala për sheshin e qytetit, vendin ku do të ketë një shëtitore dhe hapësira atraktive për qytetarët", ka thënë Muharremaj.





# Ndërtohet trotuari në Siboc të Epërm të Podujevës

Podujevë, 29 shtator (ER) - Nënkryetari i Komunës së Podujevës, Nexhmi Rudari, bashkë me drejtorin e Shërbimeve Publike, Faik Muçiqi, kanë inspektuar të martën punimet për ndërtimin e trotuarit në fshatin Siboc i Epërm të kësaj komune. Me këtë rast, nënkryetari Rudari është shprehur i kënaqur me dinamikën e kryerjes së punimeve në këtë projekt. "Do të vazhdojmë kompletimin e infrastrukturës, për të siguruar një lëvizje më të sigurt për qytetarët, veçmas për nxënësit", ka thënë Rudari. Gjatësia e trotuarit në këtë rrugë është rreth 800 metra.

# Pse PD-ja nuk vjen dot në pushtet



Nga Bedri ISLAMI

Mjaft njerëz, edhe nga ata që në tetë vjet kanë votuar për të majtën në qeverisje dhe për shefin e saj, Edi Rama, do të kishin dashur një rotacion të natyrshëm qeverisës dhe kjo për shumë arsye, që nga tradita e krijuar në vitet e pluralizmit për alternimin e pushtetit në çdo tetë vjet e deri tek ideja e lodhjes së një qeverie dhe amortizimi i saj.
Përballë së majtës në pushtet qëndron PD në opozitë. Është e natyrshme që opozita të kërkojë të jetë në drejtimin e shtetit aq sa është e natyrshme që shumica ta kërkojë qeverisjen e saj. Në fakt, alternimin dhe mosnjohjen e qeverisë aktuale opozita e ka shpallur si kredo të saj që ditën e parë të pas-humbjes të vitit 2013 dhe për tetë vjet ka mbajtur në këmbë grupin e saj të zjarrit dhe shpresëhumburit se kjo qeveri, në mos sot, do të bjerë shumë shpejt dhe se vetëm fundi i saj do të jetë shpëtimi i këtij vendi.
Që pas humbjes së qershorit 2013, opozita forcërisht dhe qorras, si askund tjetër, ka shpallur kredon e saj politike drejt asgjësimit të çdo vlere, krijimit të një turbulence të vazhdueshme në politikë, revoltën e shpallur si mjet dhe e përdorur në praktikë si dëshirë për arritje të pushtetit; ajo ka joshur padurimshëm të gjithë militantët e saj me idenë e marrjes shumë shpejt të pushtetit dhe megjithëse gjithçka ka qenë një betejë e humbur, nuk ka arritur as atë që mund të kishte arritur me seriozisht, përmes idesë dhe një norme të krijuar nga vetë ajo. Disa nga momentet më groteske të saj do të përmblidheshin tek politika e Çadrës në bulevard, ku shefat merrnin takim dy herë në ditë si në një ritual të zakonshëm, ndërsa mbrëmjet ishin mbushur me qoftet e shpërndara nga restorantet pronë e shefave të PD-së; një çadër ku dy figurat e opozitës, njëri haptas, Basha, dhe ku ishte deri asaj dite më i sinqertë, e tjetri fshehtas, Meta, synonin përmes një ngrehine çadrore të shembnin një qeverisje që e gjeti zgjidhjen përmes joshjes. Çdo gjë që ishte thënë aty, çdo përbetim që ishte shfaqur, çdo synim që ishte afishuar mori fund në një takim pak orësh mes shefit të qeverisë dhe shefit të opozitës, të cilat morën formën e një shpërblimi grotesk të një pallati të shembur në Vlorë, që edhe ashtu ishte jashtë çdo rregulli, ndarjes së përkohshme të pushtetit, si një tortë që duhet provuar së bashku dhe krijimit të një hapësire të pazakontë për shefin e së majtës që kërkoi, gjeti e mori gjithë tepsinë e pushtetit me një goditje të vetme.
Të gjitha dihen dhe janë të njohura. Ndoshta ajo që duhet gjetur deri në fund ka lidhje me njeriun që e solli në Tiranë nga Prishtina idenë e ngritjes së Çadrës, që përkoi me gjetje pak a shumë të njëjta edhe në një vend tjetër, që dikur kishte hedhur miliona dollarë për destabilizimin e Shqipërisë, në shtetin serb.
Problemi është tani: a do të ketë rotacion të pushtetit, kjo është e para dhe së dyti, nëse do të ketë, a është gati opozita e tashme për të qeverisur?
Rotacioni i pushtetit është krejt i mundshëm, nëse alternativë përballë dhe njerëzit që e bartin këtë alternativë kanë mbi vete vlera dinjitoze, janë të besueshëm, njerëzorë dhe me mend në kokë.
Cilat vlera ka sjellë në tetë vite opozita, që në fund të fundit, ashtu si ndodhi në vitin 2005, njerëzit të thonë se diçka ka ndryshuar, se tashmë të rënët nga pushteti janë ndryshe dhe se një trupë drejtuese e besueshme është duke ardhur? Problemi nis pikërisht këtu. Vlerat që përpiqet të shpallë opozita në të gjithë këto vite, të cilat kanë ndërruar herë pas here, me një lëkundshmëri të habitshme, janë pikërisht ato që nuk të ngjallin besim, për më tepër të krijojnë largësi dhe ftohtësi.
Ideja e tyre themelore në fushën e ekonomisë dhe të financës për taksën e sheshtë është krahu i fortë që i jepet asaj që pikërisht opozita e mallkon ditë e natë, megjithëse të pashpallur konkretisht se kush fshihet pas saj: oligarkia politike dhe financiare. Taksa e sheshtë forcën pikërisht këtë shtresë, që edhe kështu, në këto vite, jo vetëm është forcuar, por është bërë harbut ndaj ligjit, shtetit dhe njerëzve. Qëndron mbi to dhe, përmes kësaj takse do të jetë edhe më e plotfuqishme. Në fakt, ata që tani, nga droja e ndërrimit të pushtetit, kanë nisur të investojnë në segmentë të ndryshëm dhe të fuqishëm të opozitës, sidomos tek ata që kanë qenë në pushtet, familja kryeministrore apo që mendohet se do të jenë elita e ardhshme drejtuese.
Në tetë vjet, duke mallkuar, opozita nuk ndërtoi. Duke krijuar imazhin e kryengritësit ajo vetë ra në grevëthyese, pasi asnjëherë nuk përmbushi atë që është themelore: çuarjen deri në fund të një aksioni politik dhe mbështetjen deri në fund të një synimi. Opozita, tashmë është një llogari e njohur, ishte deri në fund mbrojtëse e sistemit të vjetër të drejtësisë, aq sa ishte e gatshme të bënte një grushtëz të vogël institucional për të mbrojtur një sekser tokash nën petkun e kryeprokurorit të republikës. Dita kur opozita e tashme synoi të mbronte me grusht dhe me çizme një sekser drejtësie dhe gjithë skutën pas tij ishte më e turpshmja për vetë atë. Ajo shkoi në këtë luftë përmes pikëpamjes berishiste që, "pas meje, të bëhet qameti", dhe nuk mendoi se ajo ditë, kur synoi të përleshej për një dogmë që e kishte krijuar vetë, nuk e çonte askund. Për fat të keq ajo bashkoi hallin e familjes kryeministrore me synimin e saj dhe e gjitha ishte njëra ndër shëmtirat e jetës plurale.
Ama, përmes saj dëshmoi se si e përfytyron ajo drejtësinë e së ardhmes, çfarë mendimi ka ajo për ruajtjen e të drejtës së ligjshmërisë për të gjithë, si u kanë shërbyer gjykatës dhe prokurorë një klase të caktuar dhe janë pasuruar vetë duke u kthyer në një oligarki të sistemit të drejtësisë. Më shumë se gjysma e Gjykatës Kushtetuese, me njerëz të emëruar prej saj, jo rastësisht, u dëbuan nga sistemi; jo rastësisht thuajse e gjithë piramida e Gjykatës së Lartë, ku kishin deleguar njerëzit e saj, u shpall e padëshiruar; Këshilli i Lartë i drejtësisë ku vegjetonin e sundonin gjingjonër ishte bërë vendi i kapjes së sistemit.
Nëse opozita do të kishte vepruar ndryshe, do e kishte mbështetur fuqishëm këtë reformë thelbësore, ajo do të ishte tejet më e besueshme sot; me krijimin e një terreni mafioz në luftën kundër saj ajo krijoi edhe hapësirën e shumicës për të bërë derivatet e saj në sundimin në të ardhmen të këtij sistemi.
Opozita e tashme pak gjëra ka harruar nga e kaluara, edhe më pak, ka mësuar nga e tashmja. Edhe largimi njëherësh nga stafi drejtues i opozitës i disa figurave të njohura - në të vërtetë akti i vetëm real dhe revolucionar i Bashës - nuk afroi figura të tjera, të cilat do të kishin një vlerë të madhe - ngjalljen e besimit.
Largimi i klasës së vjetër, të molepsur nga korrupsioni, hajdutëria, përversiteti politik vërtet i solli dëm opozitës në zgjedhjet e vitit 2017, pasi pasuesit e tyre, sidomos në Veriun e Shqipërisë mbetën të tulatur dhe kundërshtues, por dhanë mundësinë për një lëvizje të re afrimi të atyre që duke e dashur mendimin ndryshe, nuk janë të gatshëm të përkulen ndaj shefit dhe ta shohin atë si perëndi. Ajo duhej të dëshmonte se koha e berishizmit si vlerë dhe si praktikë kishte mbaruar, por duket se forca e shefit de jure të opozitës ishte deri këtu, edhe nëse ka pasur ndër mend reforma të tjera, ata mbaruan kur u shfaq shefi de fakto. I njëjti që tashmë jo pas kulisave, por haptas, urdhëron edhe se ku duhet të kandidojë shefi i opozitës, njeriu që e mori për dore dhe i dha fronin e tij, por ia mori skeptrin e urdhëresës.
Kush erdhi në vendin e atyre që ikën: shumë prej tyre të njohur për mediokritet politik dhe qytetar, për afera financiare, njëlloj të pasur si të dëbuarit dhe po aq lakmitarë dhe të paide si ata. Nëse Basha mendon se mund të ngjallë besim e shpresë me Ballinjtë, Bardhët, Gjatat, Alibeajt, budallallëqet e Spahijve që djegin shkolla dhe nuk e kanë veshur një ditë bluzën e bardhë, shefat e Lazaratit, manjakët pushtetarë të lësëisë dhe vasilët e pamençur, Salianjët, Nard Ndokët e Dulet, aferat babale apo recitimet e Dumes - Shkaut, atëherë ai nuk ka mësuar asgjë nga tetë vitet në opozitë dhe do të ishte mirë të vazhdonte të qëndronte edhe më tej.
Nëse ai nuk e ka mësuar se jo bojkoti, por pjesëmarrja; jo largimi, por prania; jo sharja, por mendimi; jo metingashët, por të mençurit; jo të korruptuarit, por të ndershmit të sjellin në pushtet - ende asgjë nuk ka mësuar. Nëse ai nuk e di se shëmbëlltyra është sprova e një lideri, ai nuk do të blinte në harkun e një viti katër vila luksoze, ndërsa flet për varfërinë, atëherë do të bënte mirë t'i jepte lamtumirën politikës dhe të kthehej në zanatin e tij. EULEX-i dhe Gjykata Speciale ka ende nevojë për përkthyes dhe hetues!
Opozita ka rreth vetes mjaft figura që do e kishin ndryshuar fizionominë dhe shfaqjen e saj politike. Që e kanë shpallur ose nuk e kanë shpallur kredon e tyre politike që duan këtë vend më shumë se një post qeveritar.
Një opozitë që kërkon të vijë në pushtet duke pasur si paterica disa partiza që kanë vetëm kryetar duhet të mendohet mirë nëse ka gjetur rrugën e duhur, apo ajo i ka humbur që në hapat e parë.
Nëse nuk e bën këtë, të mos çuditet që Rama do të kërkojë që në maj të vitit të ardhshëm mandatin e katërt.



# Shqiptarët e Ukrainës

Komuniteti shqiptar ka jetuar në territorin e Ukrainës që nga fundi i shekullit XVIII dhe fillimi i shekullit XIX. Shqiptarët u vendosën në tokën e Besarabisë moderne dhe Detit të Zi, pjesërisht në Odesë dhe në zonat rurale. Gjysmë shekulli më vonë, disa nga kolonistët e Ballkanit migruan në Detin Azov, ku gjithashtu themeluan disa fshatra ku jetojnë pasardhësit e tyre sot raporton The Ukrainer.

Në pjesën më të madhe të fshatrave të Besarabisë jetojnë kombe të ndryshme: bullgarët, shqiptarët, gagauzët, moldavët, rumunët, ukrainasit dhe kombësi të tjera, por e veçanta e tyre është se festojnë së bashku.

Për pesë vite, festivali ndërkombëtar i verës, “Bolgrad Wine Fest”, zhvillohet në Bolhrad gjatë vjeshtës, duke mbledhur jo vetëm banorët e qyteteve dhe fshatrave përreth, por edhe prodhues të verës nga e gjithë Ukraina, Bullgaria dhe Moldavia.

Çdo vit, më 6 maj, shqiptarët e Besarabisë përkujtojnë ditëlindjen e heroit kombëtar të Shqipërisë, Gjergj Kastriot Skënderbeu (fakti interesant është se në të njëjtën ditë gagauzët festojnë Shën Gjergjin, prandaj edhe shqiptarët e edhe gagauzët bëjnë kurban).

Fshati Karakurt ndodhet afër Bolhradit në Besarabia. Fjala “Karakurt” vjen nga Turqia që do të thotë “Tokë e zezë “. Ky është emri i një prej merimangave më helmuese. Ndoshta misteri nuk do të zgjidhet kurrë: pse kolonistët shqiptarë, bullgarë dhe gagauzianë e quajtën me këtë emër fshatin që ata themeluan në vitin 1811.

Në ditët e sotme, në Karakurt fliten pesë gjuhë: shqip, bullgarisht, gjuha gagauze, ukrainase dhe rusisht. Njerëzit vendas thonë se kur tre njerëz me kombësi të ndryshme takohen dhe diskutojnë me njëri-tjetrin dhe njëri prej tyre flet shqip, atëherë të tre flasin shqip sepse është gjuha kryesore aty.

Në 2001, në Karakurt jetonin deri në 3,000 njerëz, nga të cilët 1,725 janë shqiptarë. Në vitet 1860, disa shqiptarë nga Besarabia u zhvendosën në pjesën veriore të Priazovia. Numri i banorëve të këtyre fshatrave është shumë më i vogël se popullsia e Karakurtit.

Në shekullin XVI, një pjesë e shqiptarëve ortodoksë (toskë), migruan në pjesën e Bullgarisë lindore, e cila në atë kohë i përkiste Perandorisë Osmane. Shqiptarët jetuan për tre shekuj midis bullgarëve dhe gagauzëve. Shqiptarët migruan në territorin e Ukrainës në mes të shekullit të XVIII, kur këto toka ndodheshin nën pushtimin e perandorinë ruse. Në atë kohë, shumica e tyre përbëhej nga vullnetarë shqiptarë që kishin shërbyer në Marinën ruse gjatë luftës ruso-turke. Pasi lufta mbaroj, u vendosën rreth Odesës. Ka dy rrugë të njohura të lidhura me shqiptarët në qendrën historike të Odesës – Mala Arnautska dhe Velyka Arnautska. Në shekullin XIX, shqiptarët ortodoksë u quajtën “arnautë”.





Një nga shkaqet e zhvendosjes së shqiptarëve gjatë viteve 1806-1812 në Besarabi ishte për shkak të shtypjes kombëtare dhe fetare në Ballkan, që ishte nën sundimin e Perandorisë Osmane. Disa mijëra familje ortodokse shqiptare refuzuan konvertimin në fenë islame dhe filluan të kërkonin për një vend të ri për të jetuar. Në atë kohë kishte, shumë vende të pabanuara ishin në Besarabi dhe Priazovi.

Sipas burimeve të ndryshme, komuniteti i shqiptarëve të Ukrainës ka midis 5,000 dhe 10,000 anëtarë, ndërsa më pak se gjysma e tyre flasin gjuhën shqipe. Përveç fshatrave në Besarabi dhe Priazovia, shqiptarët gjithashtu jetojnë në qytete të tilla të mëdha, si: Odesa, Izmail, Donetsk, Luhansk, Kyiv, Kharkiv, Lviv, etj.

Organizata e parë shqiptare në Ukrainë, e cila u krijua në 1993, sot nuk ekziston më. Disa organizata janë krijuar në Besarabi me kalimin e kohës, të tilla si Shoqata Kulturore dhe Edukative Shqiptare: Rilindja dhe Qendra Karakurt për Kulturën Shqiptare, e cila u hap në vitin 2016. Aktualisht, Shoqëria Kulturore dhe Edukative Shqiptare “Dardania”, operon në rajonin e Priazovia.

Kreu i Shoqatës “Rilindja”, një shqiptar, Rodion Pandar, lindi në Karakurt, u diplomua nga një shkollë lokale, më pas në universitetin e Odesës. Ai ka jetuar dhe punuar në Stamboll dhe Odesë për disa vite, por më pas u kthye në vendlindjen e tij, Besarabia.

“Sipas traditës shqiptare, djali i vogël duhet të qëndrojë në shtëpinë ku ai lindi. Kjo sepse ai është trashëgimtari. Kështu që pasi punova në Stamboll (nga 1994 në 1996), prindërit e mi më thanë: ‘Bir, po mendon të kthehesh në atdheun tënd?’ Unë i thashë: ‘Baba, por unë kam një biznes shumë të mirë në Turqi!’ Dhe ai u përgjigj: ‘Nëse je shqiptar, eja në shtëpi’. Dhe u ktheva”, thotë ai.

Rodion shprehet se kombet e shumta në Karakurt dhe në fshatrat e tjerë të Besarabisë janë një fenomen i zakonshëm. Pas vitit 1991, procesi i mësimdhënies në shkollat lokale u zhvillua në rusisht për një kohë të gjatë.

““Fshati ynë ka më shumë se 200 vjet. Sot nuk ka asnjë ndryshim kush je , pavarësisht kombeve të shumta. Shumica e njerëzve të fshatit flasin tre gjuhë. Unë u detyrova të mësoja gjuhën ukrainase vetë”, shprehet Pander. */abcnews.al/*





# Ditëlindja e Servates / Introdukta e Nolit për Sojliun e Mançës

Migel de Servantes Saavedra, i njohur me emrin e shkurtër Servantes, lindi më 1547, në Alkasa de Henares të Spanjës dhe vdiq në Madrid më 23 prill 1616. Ishte i biri i dytë i një farmacisti – mjek gjysmë-vagabond, i cili shëtiste fshat më fshat e qytet më qytet për të shitur ilaçe e për të shëruar të sëmurë. Më 1570-1575 hyri në shërbimin ushtarak dhe mori pjesë në betejën navale të Lepantos së Greqisë më 7 tetor 1571, midis flotave veneciane dhe turke, ku u plagos rëndë dhe humbi dorën e mëngjër. Më 1575, kur kthehej nga Italia në Spanjë, u zu rob prej piratësh algjerianë nën kryesinë e kapedanit shqiptar Arnaut Mami dhe u mbajt i burgosur gjer më 1580, kur u çlirua, pasi pagoi shumën e caktuar për lëshimin e tij. Shkroi një shumicë të madhe veprash letrare, veçan drama e novela, të cilat s'patën asnjë sukses as në kohën e tij, as pastaj. Në ditët e pleqërisë, kur ishte 58 vjeç botoi veprën e tij me famë Don Kishotin e Mançës, e cila, me të drejtë, ia bëri emrin të pavdekur. Ky libër pati një sukses aq të madh, sa Servantesi shkroi një pjesë të dytë të kësaj vepre, si vazhdim të pjesës së parë. Suksesi i kësaj nuk qe më i vogël se ai i së parës. Bile, gjer më sot kritikët po hahen midis tyre dhe s'kanë arritur të merren dot vesh se cila nga këto pjesë është më e bukur, e para apo e dyta. Shumëve u pëlqen më tepër pjesa e dytë. Gëteja preferonte pjesën e parë. Sidoqoftë, Don Kishoti i Mançës ka qenë, për çdo kohë e për çdo vend, një nga veprat më popullore të botës, popullore edhe për çiliminjtë, edhe për filozofët e vrenjtur, si Kanti dhe Shopenhaueri, Eduard Fitzgeraldi, përkthyesi i dëgjuar i Omar Khajamit, e quan si veprën më të lezetshme të botës.

Servantesi e shkroi Don Kishotin, sikundër na thotë ai vetë, me qëllimin që të diskreditonte librat e kalorësisë. Vepra e tij, pra, ishte doemos revolucionare, se për të diskredituar librat e kalorësisë duhej të diskreditonte tërë Kohën e Mesme me të gjitha përrallat e saj. Për këtë qëllim, Servantesi zgjodhi si heronj të veprës së tij dy nga tipat më reaksionarë dhe medievalë, që kishte e që kemi akoma përpara sysh: bejlurçinën, sojliun e fandaksur të katundit, Don Kishotin e Mançës, dhe laron, sejmenin, fshatarin e varfër e të paditur, Sanço Pançën. Këta të dy marrin përsipër barrën të ringjallin periudhën e kalorësve të arratisur, domethënë ta kthejnë Spanjën edhe tërë botën nja 300 vjet prapa e të hidhen: nga Spanja e madhe e centralizuar, që ka zaptuar gjysmën e Amerikës, në Spanjën e vogël të përçarë dhe të shtypur prej arabëve; nga Koha Moderne në Kohën e Mesme; nga kapitalizmi në feudalizëm; nga dyfeku dhe topat, në shtijëzën dhe çomangën; nga shkenca në magji; nga historia në përrallat; nga përparimi në errësirën.

Me ç'mënyrë ka shpresë Don Kishoti ta mbarojë këtë vepër utopike? Fare lehtë. Duke u bërë ai vetë kalorës i arratisur, sipas librave që kishte kënduar. Pra, merr nga qilari armët e çelikta të ndryshkura e të zgjyrosura të stërgjyshërve të tij, i shkund, i lan e vishet me to; pagëzon gërdallën e tij me emrin Rosinant; zgjedh një të dashur që e riemëron Dylqinjë; dorëzohet kalorës nga një hanxhi dhe nga dy kalltakë; zgjedh Sanço Pançën si shqytar e sejmen dhe niset për të reformuar e për të shpëtuar botën. Është një fantazmë e ikur nga muzeu, që shëtit në Spanjën moderne. Është anakronizmi ambulant. Është vizionari, që nuk sheh realitetin, po ëndërron me sytë hapur. Është utopisti reaksionar, që vete prapa e jo përpara; që përpiqet ta kthejë rrotën e historisë prapa; që i bie me kokë murit të çeliktë modern.

Për të kuptuar Don Kishotin e Sanço Pançën, duhet të kuptojmë mirë klasat shoqërore spanjolle, prej të cilave kanë lindur, domethënë klasën e aristokratit të vogël, nga njëra anë, dhe klasën e fshatarit të varfër e të paditur, nga ana tjetër, në shekullin e shtatëmbëdhjetë. Në Spanjën e Kohës së Mesme aristokratët e vegjël pajtoheshin si qehajaj pranë feudalëve çiflig – sahibinj e veçanërisht si kapedanë komitaxhinj të çetave që luftonin kundër arabëve. Si u çlirua Spanja prej arabëve dhe si u modernizua përgjysmë, aristokratët e vegjël, që nuk shkuan në Amerikë, mbetën pa punë. U varfëruan, u proletarizuan, u deklasuan, ranë nga dynjallëku, se s'kishin bazë





ekonomike, se iu pre irati dhe kështu mbetën në erë. Nga oxhaku dhe nga kultura lidheshin me aristokracinë feudale të lartë, po nga varfëria zbrisnin në shkallën e fshatarëve. S'ishin as tamam aristokratë, as tamam fshatarë, po ca më keq se që të dyja palët. Pra, ishin më reaksionarë se feudalët e lartë dhe më budallenj se fshatarët e varfër e të paditur. Duke mos pasur as punë, as bazë, kërkonin dhe përpiqeshin t'i gjenin këto të dyja jo përpara, se s'kishte të pritme për klasën e tyre të vdekur, po prapa, në kohët e vjetra, kur klasa e tyre kishte një punë dhe një bazë. Kështu, Don Kishoti kërkon e gjen punë si kalorës i arratisur, siç ishin stërgjyshërit e tij. Kështu, Don Kishoti kërkon e gjen bazë në përrallat e klasës së tij, në librat e kalorësisë. Çka se bota ka vajtur përpara. Don Kishoti e merr përsipër ta kthejë botën prapa, ashtu siç e do interesi i klasës së vet.

Si shok natyral në këtë kryqëzatë, Don Kishoti gjen fshatarin e varfër e të paditur, që e ka në prag të derës, Sanço Pançën. Se edhe ky ka mbetur pa punë e pa bazë ekonomike e ndodhet në një gjendje analoge si edhe Don Kishoti. Në Spanjën e Kohës së Mesme, fshatarët e varfër kishin punë si komitaxhinj kundër arabëve, si laro, si mercenarë e si sejmenë të feudalëve. Në Spanjën moderne vdesin urie. Nuk shohin ndonjë avenir përpara, se industria nuk është zhvilluar mjaft në qytet sa t'i mbledhë si punëtorë të fabrikës. Pra, kërkojnë edhe këta punë dhe bazë prapa, në kohët e kaluara. Kështu, Sanço Pança bëhet sejmen i bejlurçinës, siç ishin stërgjyshërit e tij. Ndryshimi i madh midis Don Kishotit e Sanço Pançës është se ky i fundit s'ka kënduar libra kalorësie. Pra, ky s'i beson përrallat e Kohës së Mesme e s'ka iluzionet e Don Kishotit, dhe është shumë më i mençur se ustai i tij, se librat s'ia kanë shtrembëruar mendjen. Megjithëkëtë, ndonëse e sheh në çdo hap e në çdo aventurë që ustai i tij është i marrë, për të lidhur, prapë i vete pas, siç i vete pas çdo katundar bejlurçinës a agait të fshatit, se e ka pasur denbabaden shef, usta e kapedan nga shkaku i oxhakut, i kulturës, i traditës. Kështu, kemi gjendjen paradoksale të katundarit kundrejt bejlurçinës, të Sanço Pançës e të Don Kishotit, që mund të përmblidhet kështu: Sanço Pança është më i mençur nga Don Kishoti, se s'di të këndojë, po i vete pas, se Don Kishoti di të këndojë e se duhet, doemos nga ky shkak, të jetë më i mençur. Kështu, Sanço Pança i mbetet besnik ustait gjer në fund. Bile, kur vdes Don Kishoti, e qan me lotë të hidhur, ndonëse e merr vesh më në fund që ai e gënjeu dhe e mori më qafë me librat e kalorësisë.

Si shpjegohet populllariteti i Don Kishotit? Fare lehtë. Tipi i bejlurçinës, si dhia e zgjebur me bishtin përpjetë, dhe tipi i laros, që i vete bejlurçinës pas e përpiqet të mbajë rëndësi sipas ustait, kanë qenë gjithnjë qesharakë. Këta dy tipa bëhen më qesharakë, kur vishen si kalorës të arratisur dhe shëtitin si në karnavalet. Pastaj bëhen më qesharakë, kur këta të dy gogozhelë pretendojnë se do ta kthejnë rrotën e historisë prapa e do të ringjallin një periudhë që ka vdekur përgjithnjë. Përfundimi ca më qesharak i përpjekjeve të tyre i vë tenxheres kapakun. Çift më qesharak, me rroba më fantastike, me qëllime më absurde e me përfundime më groteske nuk mund të imagjinohej. Këtu kemi në fytyrën e Don Kishotit poezinë e bejlurçinës, dhe në fytyrën e Sanço Pançës prozën e laros. Kur bëhen qesharakë dhe hanë dru, doemos këndonjësit gëzohen, që në fytyrën e tyre bëhen qesharakë dhe hanë dru dy klasat shoqërore më të urryera dhe më prapavajtëse, klasa e bejlurçinës dhe klasa e laros. Se këta i ka pasur mileti mbi kokë si oficerë, si nëpunës, si ushtarë, si zaptie, si komitaxhinj, si hajdutë, si qehajaj, shkurt, si vegla dhe agjentë të feudalëve e të shtetit feudal. Kur rrihen këta, mileti ndien atë gëzim që quajnë gjermanët Schadenfreude, se i ngjan një mjerim armikut.

Po kjo vepër nuk do të ishte aq e bukur, sikur të na bënte vetëm të qeshnim. Na bën edhe të qajmë. Se Don Kishoti është një idealist në tërë kuptimin e fjalës. Të gjitha këto i bën për të mirën e njerëzisë dhe aspak për ndonjë interes vetjak. Ka një optimizëm e një entuziazëm e një durim e një besim e një perseverancë heroike, që meritonin të përdoreshin për një çështje më të mirë. Na vjen keq kur shikojmë që i harxhon më kot për një çështje të humbur e që sakrifikohet për përrallat e reaksionit. Gjithashtu na mallëngjen edhe Sançoja me besnikërinë që tregon kundrejt Don Kishotit. Na këputet shpirti kur shikojmë fshatarin e varfër dhe të paditur të vdesë për bejlurçinën, i cili e merr më qafë dhe e handakos me profka dhe iluzione.

Në Shqipëri kjo vepër do të kuptohet më mirë se kudo gjetkë. Se atje tipat e bejlurçinës dhe të laros i gjejmë në çdo çap. Pothuaj të gjithë aristokratët tanë, me ca përjashtime të paka, janë të deklasuar pa bazë ekonomike, dhe kanë rënë në klasën e bejlurçinave, që kur u shkëput Shqipëria prej Turqisë. Që atëherë aristokratët tanë, që i shërbenin Turqisë si kondotierë dhe shefë bashibozukësh, kanë mbetur pa punë. Gjithashtu, kanë mbetur pa punë dhe pa bukë fshatarët dhe malësorët e varfër, që shkonin në kohët e vjetra me bejlerët si bashibozukë dhe hajdutë për të plaçkitur Evropën, Azinë dhe Afrikën. Këto të dy elementë përpiqen tani të përjetësojnë në Shqipëri një gjendje feudale, mediavale, prapanike dhe reaksionare, si atë të Turqisë së vjetër, të vdekur, përgjithnjë, se ashtu ua do interesi i klasës, se ashtu gjejnë punë dhe bukë. Bejlurçinat e larot e Shqipërisë na bëjnë sot të qeshim e të qajmë me prapavajtjen e tyre, tamam si me Don Kishotin e me sançon. Dhëntë zoti të na bëjnë nesër të qeshim vetëm, se na bënë të qajmë mjaft.




Sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

# Arbëria nuk njeh humbje në Superligë



Klubi i Arbërisë që u promovua në këtë edicion në Superligë vazhdon t'i befasojë skuadrat e fuqishme në elitë, pasi në katër ndeshjet e para nuk ka pësuar ende humbje. Kjo skuadër i ka mposhtur Trepçën '89 dhe Besën, kurse ka luajtur baras me Prishtinën dhe Feronikelin

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 29 SHTATOR - Skuadra e Arbërisë nuk po njeh humbje në Superligë, pasi të martën e ka regjistruar edhe një tjetër rezultat pozitiv. Pas fitores ndaj Trepçës '89, barazimit me Prishtinën dhe fitores në xhiron e tretë ndaj Besës në Pejë, Arbëria e ka befasuar edhe Feronikelin, pasi i mori një pikë në ndeshjen e javës së katërt në Superligë (0-0).
Skuadra e "Niklit" për një nuancë ishte më e mirë, por dyzet e pesë minutat e parë përfunduan pa gola 0-0. Në fillim të pjesës së dytë, Arbëria doli në rast të mirë shënimi, por kapiteni Labinot Ibrahimi gjuajti lart mbi portën e mysafirëve. Në minutën e 57 Besmir Bojku provoi nga gjuajtja e lirë por, pa sukses. Një minutë më vonë, Da Silva depërton bukur në zonë, mirëpo mbrojtja e vendësve ishte në vend dhe e largoi rrezikun. Koshtanjeva, Bahtiri dhe Zaberxha te vendasit nuk arritën të shënojnë në tentimet e tyre, kurse në anën tjetër për mysafirët një tentim e bëri edhe Albert Dabiqaj, por që nuk arriti ta zhbllokojë rezultatin. Duhet cekur se skuadra nga Drenasi kishte më shumë iniciativë, por nuk arriti ta konkretizojë dhe në fund skuadrat ndanë pikët. Për Arbërinë që drejtohet nga Arbnor Morina, ky barazim është sukses i madh për faktin se në katër xhirot e parë në Superligë nuk ka pësuar humbje, kurse ka grumbulluar tetë pikë. Feronikeli i Afrim Tovërlanit nga katër ndeshjet e fituara ka grumbulluar pesë pikë.

### Sot zhvillohen tri ndeshje, nesër një

Sot (e mërkurë) zhvillohen tri ndeshje të tjera të javës së katërt në elitë, përfshirë edhe derbin në mes të Llapit dhe Ballkanit. Skuadra e drejtuar nga Tahir Batatina në dy ndeshjet e zhvilluara ka pësuar dy humbje dhe është në kërkim të fitores së parë në këtë edicion. Në anën tjetër Ballkani ka treguar stabilitet në ndeshjet e para dhe ka arritur që nga tri ndeshjet t'i fitojë dy dhe një tjetër të marrë barazim. Kjo ndeshje zhvillohet në stadiumin "Zahir Pajaziti" dhe do ta ketë vëmendjen e tërë opinionit futbolldashës. Ndërsa kampionia në fuqi, Drita nga Gjilani, sot e zhvillon ndeshjen e parë në edicionin e ri sepse ndeshjet e para nuk i zhvilloi për shkak të pjesëmarrjes në garat ndërkombëtare. Ndeshja e parë për kampionët do të jetë ndaj Besës së Pejës. Ndeshja tjetër është ajo në mes të Trepçës '89 dhe Prishtinës. Të enjten zhvillohet ndeshja e fundit për këtë xhiro në mes të Drenicës dhe Gjilanit.

**SUPERLIGA**

**Arbëria - Feronikeli 0-0**

**Të mërkurën takohen:**
**15:00 Llapi - Ballkani**
**15:00 Trepça '89 - Prishtina**
**15:00 Drita - Besa**

**Të enjten takohen:**
**15:00 Drenica - Gjilani**

## SHKURT

### KB Ponte Prizreni përforcohet me Ty Nichols

KB Ponte Prizreni ka njoftuar se ka kompletuar skuadrën me transferimet e huaja, pasi të martën në Kosovë ka arritur transferimi i fundit, Ty Nichols. "Para pak çastesh edhe lojtari i fundit i huaj Ty Nichols ka arritur në aeroportin 'Adem Jashari'. Me Ty skuadra është kompletuar, pasi nga dje kemi filluar edhe parapërgatitjet për edicionin e ri", thuhet në njoftimin e klubit nga Prizreni.

### Dy lojtarë të Maqedonisë infektohen me Covid-19

Pandemia Covid-19 është duke "sulmuar" lojtarët e Maqedonisë së Veriut. Dy lojtarë të kësaj kombëtare kanë rezultuar pozitivë me Covid-19. Bëhet fjalë për portierin Martin Bogatinov si dhe sulmuesin Jovan Kostovski, njofton "Ekipa.mk". Të dy lojtarët janë pjesë e klubit Ethnikos Achna të Greqisë, tek e cila dolën pozitivë 16 lojtarë. Ata kanë konfirmuar se do të jenë për 14 ditë në izolim, ndërsa në karantinë janë që nga e premtja. I dyshuar mbetet edhe sulmuesi me përvojë Goran Pandev, pasi 14 anëtarë të klubit të tij, Genoa, kanë dalë pozitivë.

### Ujkan Karanezi vazhdon me Bashkimin

KB Bashkimi ka nisur t'i "blindojë" basketbollistët që i ka në ekip, ndërkohë që po planifikon të bëjë edhe përforcime. Prizrenasit kanë njoftuar se një ndër lojtarët më të rëndësishëm të skuadrës, Ujkan Karanezi, do të vazhdojë t'i mbrojë ngjyrat portokall e zi edhe në sezonin 2020/2021. Ai i ka qëndruar besnik klubit të vendlindjes duke nënshkruar kontratë të re. Në stinorin që e lamë pas, Ujkani ka pasur mesatare prej 9.6 pikësh dhe 6.6 kërcimesh për ndeshje. Sezoni i ri i Superligës së basketbollit do të fillojë në fund të muajit tetor.

### Muriqi fiton betejën me Covid-19

Vedat Muriqi fiton betejën me koronavirusin. Transferimi më i fundit te Lazio ka marrë lajmin e mirë se e ka mposhtur Covid-19, ndërsa pret edhe përgjigjen e testit të dytë. Duke iu referuar asaj që shkruan "Corriere Dello Sport", shumë shpejt Muriqi do të udhëtojë drejt Italisë për t'i nisur përgatitjet me skuadrën kryeqytetase, edhe pse debutimi i tij pritet të ndodhë pas pauzës së kombëtareve. Blerja e kartonit të Muriqit nga Fenerbahçe iu kushtoi arkave të Lazios 18 milionë euro, plus dy të tjera në formë bonusesh.

### Mick Schumacher fundjavën e ardhshme debuton në Formula 1

Emri Schumacher është zyrtarisht përsëri në Formula 1. Siç njoftoi Ferrari të martën pasdite, Mick Schumacher do ta bëjë debutimin në garën në Nürburgring, për Çmimin e Madh të Eifel, që zhvillohet fundjavën e ardhshme. Djali i legjendës Michael Schumacher do ta filloje praktikën e parë të lirë të premten për ekipin Alfa Romeo, i cili është i pajisur me motorë nga Ferrari. Përveç 21-vjeçarit, edhe Callum Ilott do ta drejtojë makinën e Alfa Romeot në praktikën e lirë. Robert Shwartzman gjithashtu do të drejtojë një makinë të Formula 1 në finalen e sezonit në Abu Dhabi. "Jam shumë i lumtur që e kam këtë shans në praktikën e lirë. Fakti që pjesëmarrja ime e parë në Formula 1 do të jetë para tifozëve të mi në shtëpi në Nurburgring në fundjavë, e bën këtë moment edhe më të veçantë", ka thënë Mick i entuziazmuar.

## Sot mbahet aktiviteti në lojën 3×3




PRISHTINË, 29 SHTATOR - Sot (e mërkurë) do të mbahet aktiviteti në lojën 3×3 në të dyja konkurrencat deri në moshën 15-vjeçare. Aktiviteti organizohet nga Federata e Basketbollit e Kosovës në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në kuadër të Javës Evropiane të Sportit #BEACTIVE. Aktiviteti do të mbahet në Prishtinë dhe Prizren. Në Prishtinë do të mbahet tek ish-Kroi i Bardhë, në Lagjen e Dardanisë, të mërkurën nga ora 18:00 deri në orën 21:00. Ndërkohë, në Prizren mbahet nga ora 14:00 deri në ora 17:00 te Qendra Sportive, po ashtu të mërkurën. Ftohen të gjithë të interesuarit të marrin në këtë aktivitet, ku do të pranishëm do të jenë edhe Ministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), Vlora Dumoshi, drejtuesit e lartë të FBK-së, përfaqësues nga MKRS-ja, përfaqësues nga Komuna e Prishtinës dhe shumë personazhe të njohura nga sporti i basketbollit. “Qëllimi i aktivitetit nuk është garues, por të jetë një mesazh për gjeneratat e reja që të merren me basketboll dhe të jenë sa më aktivë. Organizatorët zotohen se do t'i respektojnë masat anti-Covid, ku secili do të ketë maskë, do të respektohet distanca fizike dhe do të ketë dezinfektues”, thuhet në njoftimin e FBK-së.

# Liga Unike, ndër gjërat më të mëdha që i ka ndodhur basketbollit mbarëshqiptar



TIRANË, 29 SHTATOR - Një nga basketbollistët më të dalluar shqiptar në vitet e fundit është Gerti Shima. Ai ka luajtur për Bashkimin, Pejën dhe Sigal Prishtinën në Kosovë, kurse për Valbonën dhe Tiranën në Shqipëri. Shima ka folur për krijimin e Ligës Unike ndërmjet Federatës së Basketbollit të Kosovës dhe Federatës Shqiptare të Basketbollit. “Është një nga gjërat më të mëdha, që mund të them se i ka ndodhur basketbollit mbarëshqiptar. Kam shumë, shumë vite që në fillimet e karrierës sime, që dëgjoj për këtë ligë dhe më në fund u arrit në vitin 2020”, është shprehur Shima për faqen zyrtare të FBK-së. “Besoj se kjo ligë do t'i japë shumë basketbollit nga të dy krahët sepse do të ketë më shumë ndeshje. Do t'u jepet mundësia shumë lojtarëve vendorë të luajnë dhe ta marrin përvojën e duhur për më vonë në gara më të larta me klube apo dhe me kombëtaren”, ka shtuar Shima. Ai flet edhe se kush mund të përfitojë më shumë nga Liga Unike. “E kam thënë dhe vazhdoj të them që nga krijimi i kësaj lige do të përfitojë më shumë Shqipëria nga të gjitha anët. Besoj se interesimi nuk ka për të munguar pavarësisht situatës që ndodhemi. Edhe në këtë rast do të marrim mësime nga skuadrat e Kosovës nga ana organizative, si nga ekipet, po ashtu edhe nga tifozët. Gjithashtu, kryesorja edhe pa afrimin e sponsorëve”, ka deklaruar Shima, i cili ka luajtur për shumë vite në Kosovë dhe ishte i dashur shumë nga tifozët. “Më mungon shumë Kosova dhe e kujtoj me nostalgji, sepse kam kaluar jo më pak se gjashtë vjet të suksesshme”, ka përfunduar basketbollisti i Tiranës dhe Kombëtares shqiptare.

# Bottas, Hamiltonit: Kurrë nuk është vonë të luftosh për titull



NASTOLA, 29 SHTATOR - Valtteri Bottas korri suksesin e dytë sezonal me makinën e Mercedesit, teksa triumfoi në garën e Çmimit të Madh të Rusisë në Formula 1. Një paraqitje e mirë e finlandezit, që përtoi edhe nga penalizmi që mori shoku i tij i skuadrës Lewis Hamilton (i treti), për ta ngushtuar diferencën në renditjen e përgjithshme. Tashmë Hamiltoni kryeson me 205 pikë, ndërsa Bottasi ndodhet i dyti me 161 pikë. Pra 44 pikë më pak, por botërori është ende i gjatë. “Kishte kaluar mjaft kohë nga fitorja e fundit, por e di që nëse do të kem mundësi do të arrij të fitoj sërish. Jo vetëm një garë, por disa të tilla dhe, pse jo, titullin kampion. E vetmja gjë që duhet të bëj është të ruaj qetësinë, përqendrimin dhe të pilotoj sa më shpejt të mundem. Nuk do të dorëzohem deri në fund, pasi nuk i duhet asnjëherë. Nuk është kurrë vonë të duelosh për titullin”, ka thënë Bottas.

## Mainzi shkarkon trajnerin

Në Bundesligë kanë mjaftuar dy ndeshje për t'u shkarkuar dy trajnerë. Pas Schalkes, që shkarkoi Wagnerit, ishte radha e Mainzit, që largoi nga drejtimi i skuadrës trajnerin Achim Beierlorzer, i cili e mori drejtimin e ekipit nëntorin e vitit të kaluar. 52-vjeçari pagoi kështu dy humbjet në kampionat ndaj Leipzigut dhe Stuttgartit. Për momentin drejtimi i skuadrës i është besuar zëvendëstrajnerit Jan-Moritz Lichte.

## SHKURT

### Zeqiri, afër zyrtarizimit te Brightoni

Brighton & Hove Albion është shumë pranë që ta kompletojë transferimin e Andi Zeqirit nga skuadra zvicerane, FC Lausanne-Sport. Është raportuar se 21-vjeçari iu është nënshtruar ekzaminimeve mjekësore të hënën dhe është në prag të zyrtarizimit - bën të ditur “The Argus”. Skuadra italiane, Parma, ka qenë favorite për nënshkrimin e Zeqirit para se të dilte në skenë Brightoni. Klubi anglez është i interesuar të bëjë përforcime para mbylljes së afatit kalimtar veror, sidomos në fazën ofensive. Zeqiri ka lënë përshtypje të mirë me skuadrën e Lausanne në edicionin e kaluar, duke shënuar 22 gola në të gjitha garat dhe ekipi i tij u promovua në Superligën e Zvicrës.

### Arteta: Jemi larg Liverpoolit

Mikel Arteta ka pranuar se Liverpooli i ka treguar Arsenalit saktësisht se sa larg janë ata nga mundësia për të luftuar me kampionin aktual pas humbjes 3-1 të hënën. “Topçinjtë” kaluan të parët në avantazh, por pësuan tre gola deri në përfundimin e ndeshjes. “Ne luajtëm në një ndeshje shumë të rëndësishme. Realiteti është që ata janë shumë larg nesh në shumë aspekte. Mund të shihni që ka një distancë kualitetesh mes dy ekipeve”, ka thënë fillimisht Arteta për “Sky Sport”. “Jam shumë i lumtur me mënyrën se si ekipi luftoi dhe vazhdoi të besonte. Ky është standard të cilin ne e kemi arritur. Kisha ndjenjën se do të kishim raste shënimi në pjesën e dytë dhe, mbase, i kishim mundësitë më të mira, por ato mundësi duhen konkretizuar”, ka deklaruar trajneri i Arsenalit.

### Presidenti i Atleticos, Messit: Je i mirëseardhur t'i bashkohesh Suarezit

Lionel Messi është i mirëseardhur t'i bashkohet Luis Suarezit në Atletico Madrid, nëse vërtet dëshiron të luajë ende përkrah sulmuesit uruguaian, thotë presidenti i Atleticos, Enrique Cerezo. Barcelona e largoi Suarezin javën e kaluar pa kurrfarë ceremonie lamtumire pas gjashtë vjetëve në Camp Nou, duke ia shitur atë rivalit Atletico për vetëm 6 milionë euro. Gjatë vjetëve në Barçë, Suarezi u bë golashënuesi i tretë më i mirë në histori të klubit, por largimi i tij e ka mllefosur tej mase mikun e tij të ngushtë, Messi, i cili edhe vetë deshi të largohej, por s'u lejua. Pasi dështoi ta largohej nga Camp Nou, superylli argjentinas i vazhdoi akuzat ndaj drejtuesve të klubit duke i kritikuar publikisht për mënyrën sesi e larguan shokun e tij. Dhe tani, Cerezo publikisht e ka këshilluar Messin të ribashkohet me Suarezin në Wanda Metropolitano. “Nëse Leo Messi dëshiron të luajë me Luis Suarezin, i them të njëjtën gjë që thuhet me ëmbëlsirën: 'Le të vijë në shtëpi për Krishtlindje'. Me dëshirë mund të arrihet gjithçka”, ka deklaruar Cerezo.

### Paqueta largohet nga Milani, transferohet në Lyon

Lucas Paqueta largohet nga Milani pas një viti e gjysmë, ku pritshmëritë për të ishin të mëdha. Braziliani ka vendosur të largohet nga skuadra italiane teksa do të kalojë te Lyoni në Francë. Sipas “Sky Sport” së fundmi mesfushori ka përshëndetur shokët e tij në Milanelo dhe është larguar. Detajet për kalimin e tij te Lyoni nuk janë bërë ende të ditura teksa nuk dihet nëse kalon në huazim me të drejtë blerje për 18 milionë euro, siç ishte propozimi i parë i francezëve, apo në huazim me detyrim blerje për 22 milionë euro, siç ishte kërkesa e Milanit.

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Ref. Nr.1740 Pejë, 29.09.2020

Senati i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë në bazë të kompetencave të përcaktuara sipas nenit 102 të Statutit të Universitetit, vendimit të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës ref. nr. 710 datë 18.09.2020, në mbledhjen e mbajtur me datë 24.09.2020 miratojë propozimet e njësive akademike për shpalljen e

**KONKURSIT**
**për pranimin e studentëve në vitin e parë të studimeve postdiplomike-Master për vitin akademik 2020/2021**

1. Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë, në studimet postdiplomike-Master, për vitin akademik 2020/2021 do të regjistrojë **248** studentë.

2. Në kuadër të numrit të përgjithshëm të përcaktuar si në paragrafin 1 të këtij konkursi duke u bazuar në UA Nr.09/2016 të MASh, Universiteti do të regjistrojë deri ne 12% studentë të rregullt nga komuniteti jo-shumicë. Kuota prej 12% të vendeve të rezervuara për regjistrim të studentëve nga komuniteti jo-shumicë do të shpërndahet në mënyrë proporcionale sipas përqindjes së numrit të përgjithshëm të studenteve për secilin program të fakulteteve veç e veç.

**I. KUSHTET E PËRBASHKËTA TË KONKURSIT**

1. Në studimet postdiplomike-Master në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë, mund të pranohen kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet Bachelor apo studimet themelore para hyrjes në fuqi të Deklaratës së Bolonjës në të gjitha Institucionet e akredituara të Arsimit të Lartë në Kosovë. Në kushte të barabarta, përparësi në pranim do të kenë kandidatët, të cilët i kanë mbaruar studimet themelore – Bachelor në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë.

2. Të drejtë pranimi në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë kanë edhe të gjithë kandidatët tjerë të cilët i kanë përfunduar me sukses studimet themelore jashtë Kosovës. Ne raste të tilla, kandidati duhet të sjellë dëshminë (vërtetim apo vendim) mbi akreditimin e institucionit në të cilin i ka mbaruar studimet paraprake. Të gjithë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet themelore jashtë Kosovës me rastin e paraqitjes në konkurs, duhet t'i kenë të nostrifikuara diplomat e përfundimit të studimeve themelore. Kandidatë jo kosovarë llogariten të gjithë ata kandidatë që nuk janë shtetas të Kosovës. (Vendimi për njohje/nostrifikim të diplomave lëshohet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Kosovës).

3. Kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet paraprake në një program studimi, mund të konkurrojnë për regjistrim në studimet Master në një program tjetër. Në rast pranimi, Komisioni i Studimeve i njësisë akademike cakton provime diferenciale, të cilave duhet t'iu nënshtrohen paraprakisht kandidatët. Komisioni i Studimeve cakton numrin e provimeve varësisht nga shkalla e krahasueshmerisë/ngjashmërisë së programit të ndjekur në studimet paraprake të kandidatit. Në raste të tilla, kandidatët ndjekin ligjëratat në vitin vijues akademik dhe iu nënshtrohen provimeve diferenciale në afatin e qershorit dhe shtatorit. Kandidatët do të kenë më së shumti deri në pesë provime diferenciale, të cilave do t'iu nënshtrohen para komisionit prej tre anëtaresh ndërsa procesverbalet e provimeve të tilla ratifikohen nga këshilli i njësisë akademike përkatëse.

4. Përjashtim nga paragrafi 3 i pikës I të këtij konkursi bëhet për programet studimore me specifika të veçanta, të cilat i përcaktojnë vete njësitë akademike.

5. Kandidatët të cilët kanë të regjistruar një program studimi në cilindo nivel të studimit në kuadër të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, nuk kanë të drejtë konkurrimi në program tjetër studimi në UHZ pa përfunduar studimet në programin ku janë duke vijuar studimet ose pa u çregjistruar nga programi aktual i studimeve.

6. Kandidatët të cilët aplikojnë në këtë konkurs për pranim si student në vitin akademik 2020/2021 nuk mund të konkurrojnë më shumë se në një fakultet apo program.

**II. MËNYRA E PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE**

1. Përzgjedhja e kandidatëve për të gjitha fakultetet do të bëhet sipas kritereve si në vijim:

Numri maksimal i pikëve sipas kritereve vijuese është 100 pikë, dhe atë:
- Suksesi në studimet themelore deri në 30 pikë;
- Suksesi në provimin pranues deri në 70 pikë.

2. Të drejtë radhitjeje, përkatësisht pranimi kanë vetëm kandidatët që arrijnë 40% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues.

3. Kandidatët të cilët nuk arrijnë 40% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues nuk mund të pranohen edhe nëse mbeten vende të paplotësuara sipas konkursit.

4. Fakultetet me specifika të veçanta organizojnë provim praktik në lëndë dhe disiplina përkatëse.

5. Për funksionimin e programit të fakultetit është i nevojshëm numri minimal prej 2O studentëve, përveç Fakultetit të Arteve, ku grupi mund të formohet edhe me më pak studentë.

**III. AFATET KONKURSIT**

Për regjistrimin e studentëve në vitin e parë të studimeve oraret do të jenë si në vijim:

1. Paraqitja e dokumenteve zgjatë prej datës 29.09.2020 deri më 10.10.2020 nga ora 09:00 - 15:00 (dokumentet do të pranohen çdo ditë me përjashtim të ditës së diel)

2. Me rastin e paraqitjes, kandidatët duhet t'i sjellin këto dokumente:
   - Fletëparaqitja e plotësuar e cila shkarkohet gjatë aplikimit online nga interneti: Vegza (Linku) për aplikim Online përmes Internetit është: http://sems.unhz.eu/AplikimiMaster
   - ekstraktë/certifikatë e lindjes (origjinal),
   - diplomën origjinale, ose të noterizuar, përkatësisht certifikatën e diplomës – origjinal ose të noterizuar,
   - dëshminë e akreditimit të institucionit të arsimit të lartë (për kandidatë që kanë mbaruar studimet jashtë vendit dhe në institucionet private të Arsimit të Lartë të Republikës së Kosovës).
   - Kandidatët me rastin e aplikimit paguajnë 2.50 euro (fletëpagesa shkarkohet me rastin e aplikimit).

   Kandidatët e pranuar me rastin e regjistrimit të semestrit do të paguajnë tarifat e shkollimit sipas UA 17/2014 të datës 06.05.2014.

3. Provimi pranues do të mbahet me 13.10.2010 sipas orarit si në vijim:

   - Fakulteti i Biznesit 13.10.2020 në ora 10.00
   - Fakulteti Juridik 13.10.2020 në ora 10.00
   - Fakulteti i Arteve 13.10.2020 në ora 9.00

4. Të gjithë kandidatët në provim pranues duhet ta posedojnë njërin nga këto dokumente identifikuese: letërnjoftim, pasaportë apo patentë shofer, pa njërën nga të cilën nuk mund t'i nënshtrohen provimit pranues.

Në kohën e mbajtjes së provimit pranues ndalohet përdorimi i telefonave celularë!

Duke pasur parasysh situatën me pandemi COVID-19, të gjithë kandidatët, duke filluar nga paraqitja e dokumenteve, provimi pranues dhe regjistrimi duhet të respektojnë rekomandimet e IKSHPK-së dhe të jenë të pajisur me maska mbrojtëse.

5. Shpallja e rezultateve e provimit pranues bëhet më 14.10.2020

**IV. E DREJTA E ANKESËS DHE AFATI PËR ANKESË**

Kandidatët të cilët nuk janë pranuar në vitin e parë të studimeve Master mund të ankohen kundër vendimit brenda tri ditëve të punës në fakultetet përkatëse pas shpalljes së rezultateve të zgjedhjes, përkatësisht deri më 19.10.2020**.** Vendimi përfundimtar rreth ankesës merret nga komisioni i ankesave në Rektorat.

**V. SHPALLJA E REZULTATEVE PËRFUNDIMTARE DHE REGJISTRIMI I KANDIDATËVE TË PRANUAR**

1. Rezultatet përfundimtare në bazë të vendimit të komisionit të ankesave shpallen më së largu deri më 23.10.2020.

2. Regjistrimin e kandidatëve të pranuar do ta bëjë Administrata Qendrore e Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, sipas këtij orari:

   - Fakulteti i Biznesit më 26.10.2020 prej orës 9:00 - 15:00 në objektin e Fakultetin e Biznesit;
   - Fakulteti Juridik më 27.10.2020 prej orës 9:00 - 15:00 në objektin e Fakultetit Juridik;
   - Fakulteti i Arteve 27.10.2020 prej orës 9:00 - 15:00 në objektin e Fakultetit Juridik.

3. Kandidatet e pranuar për regjistrim duhet të paraqesin**:**
   - Fletëregjistrimin e plotësuar (i cili gjenerohet me rastin e fotografimit në Administratën Qendrore të UHZ-ës, aty ku bëhet regjistrimi)
   - Dy fotografi formati 6x4 cm
   - Fletëpagesën (e cila shkarkohet nga interneti) në shumën prej **150 €** për një semestër. Pagesa bëhet në njërën prej bankave afariste.

Për informata të tjera të nevojshme, kandidatët mund t`i drejtohen fakultetit përkatës ose ta hapin faqen e internetit **www.unhz.eu**

4. Kandidatët të cilët nuk kanë arritur që të regjistrohen brenda afateve të përcaktuara si më sipër, ju caktohet një afat shtesë konform udhëzimeve të MASh, i cili do të publikohet në ueb faqen e Universitetit

- **Fakulteti i Biznesit**

| Nr. | Programi | Master | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Gjuhë shqipe | Gjuhë boshnjake | Total |
| 1. | Menaxhim Biznesi | 120 | 30 | 150 |
| 2. | Menaxhim i Burimeve Njerëzore | 50 | / | 50 |

**Provimi pranues do të mbahet nga këto lëndë:**

**Për Programin Menaxhim Biznesi në lëndët**:
- Bazat e Menaxhmentit dhe
- Hyrje në Biznes.

**Për Programin Menaxhim i Burimeve Njerëzore në lëndët:**
- Menaxhimi i Burimeve Njerëzore dhe
- Menaxhmenti Strategjik.

- **Fakulteti Juridik**

| Nr. | Programi i studimit | Master |
|---|---|---|
| | | Të rregullt |
| 1. | E Drejta Ndërkombëtare dhe Evropiane | 40 |

**Provimi pranues do të mbahet nga ketë lëndë:**

- E drejta ndërkombëtare publike
- E drejta e Unionit Evropian

Në studimet postdiplomike-Master në Fakultetin Juridik të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, mund të pranohen kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet Bachelor 4(katër vjeçar), respektivisht 240 ECTS në fushën e drejtësisë.

- **Fakulteti i Arteve**

| Nr. | Programi i studimit | Master |
|---|---|---|
| | | Të rregullt |
| 1. | Edukim Muzikor | 8 |

**Provimi pranues do të mbahet nga ketë lëndë:**
1. Pedagogji Muzikore (Metodika e mësimdhënies së muzikës)
2. Harmoni (Detyrë Harmonike për formacionin S,A,T,B a. Harmonizimi i sopranit b. Harmonizimi i basit, detyra zhvillohet deri në alteracione)

Në studimet postdiplomike-Master në Fakultetin e Arteve të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, mund të pranohen kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet Bachelor 4(katër vjeçar), respektivisht 240 ECTS.

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Ref. Nr. 1740 Peć, 29.09.2020

Senat Univerziteta "Haxhi Zeka" u Peći je, na osnovu određenih kompetencija člana 102 Statuta Univerziteta, odluke Ministarstva za Obrazovanje i Nauku, br. ref. 710 datuma 18.09.2020, na održanom sastanku 24.09.2020 usvojio prijedlog akademskih jedinica za objavljivanje

**KONKURSA**
**Za priejm novih studenata na prvoj godini postdilomskih (Master) studija za akademsku 2020/2021 godinu**

1. Univerzitet "Haxhi Zeka" u Peći će na postdiplomske (Master) studije za akademsku 2020/2021 godinu upisati **248** studenata.
2. U okviru ukupnog broja kao što je određeno u prvom paragrafu ovog konkursa, na bazi AU br. 09/2016 Ministarstva za Obrazovanje i Nauku, Univerzitet će upisati do 12% redovnih studenata manjinskih zajednica. Udio od 12% rezervisanih mjesta za upis studenata koji pripadaju manjinskim zajednicama, će biti podjeljena srazmjerno postotku ukupnog broja studenata za svaki pojedinačni fakultet.

**I. ZAJEDNIČKI USLOVI KONKURSA**

1. Na postdiplomskim (Master) studijama na Univerzitetu „Haxi Zeka" u Peć, mogu biti primljeni kandidati koji su završili osnovne (Bachelor) studije prije ulaska Bolonjske deklaracije u svim akreditovanim visokoškolskim institucijama na Kosovu. U zajedničkim uslovima, prednost prijema imaju kandidati koji su završili osnovne (Bachelor) studije na Univerzitetu „Haxhi Zeka" u Peći.
2. Pravo na upis na Univerzitetu „Haxi Zeka" u Peć imaju svi kandidati sa Kosova, kandidati koji su uspješno završili osnovne studije van Kosova. Tokom prijave kandidat treba da priloži dokaz (potvrdu ili rješenje) o akreditaciji ustanove u kojoj je završio prethodne studije. Svi kandidati koji su završili osnovne studije van Kosova tokom apliciranja moraju imati nostrifikovane diplome sa osnovnih studija. Kandidatima, koji nisu sa Kosova, smatraju se oni kandidati koji nisu državljani Kosova. (Rješenje o priznavanju/nostrifikacija diplome koju izdaje Ministarstvo Obrazovanja i Nauke Republike Kosova).
3. Kandidati koji su završili osnovne studije na jednom programu, mogu konkurisati za upis na postdiplomske studije na drugom programu. U slučaju prijema, Komisija za studije akademske jedinice imenuje diferencijalne ispite, koje kandidati moraju položiti unaprijed. Komisija za studije određuje broj ispita u zavisnosti od stepena uporedivosti/sličnosti programa praćenog u prethodnim studijama kandidata. U takvim slučajevima kandidati pohađaju predavanja u narednoj akademskoj godini i polažu diferencijalne ispite u junu i septembru. Kandidati će imati najviše pet diferencijalnih ispita, koji će biti predati tročlanoj komisiji, dok zapisnike o tim ispitima potvrđuje vijeće odgovarajuće akademske jedinice.
4. Izuzetak od paragrafa 3 tačke 1 ovog konkursa čine studijski programi sa posebnim specifikacijama, koje utvrđuju akademske jedinice.
5. Kandidati koji su upisani na nekom od programa bilo kog nivoa u okviru Univerziteta „Haxhi Zeka" u Peći, nemaju pravo aplikacije na nekom drugom programu studije na UHZ dok ne završe prethodno upisane studije ili dok se ne ispišu sa aktuelnog programa studija.
6. Kandidati za upis na Univerzitetu „Haxhi Zeka" za akademsku 2020/2021 godinu ne mogu konkurisati na više od jednog fakulteta, smjera ili programa.

**II. NAČIN IZBORA KANDIDATA**

1. Izbor kandidata za sve fakultete će se odviti na osnovu sljedećih kriterijuma:
   - Maksimalan broj poena na osnovu sljedećih kriterijuma je 100 poena i to:
   - Uspjeh na osnovnim studijama do 30 poena, i
   - Uspjeh na prijemnom ispitu do 70 poena
2. Pravo na upis imaju samo kandidati koji postignu 40% od ukupnog broja predviđenih poena za prijemni ispit.
3. Kandidati koji ne postignu najmanje 40% od ukupno predviđenog broja poena na prijemnom ispitu ne mogu biti primljeni iako bude imalo praznih mjesta na osnovu konkursa.
4. Fakulteti sa posebnim specifikacijama organizuju održavanje prijemnog ispita za nastavne predmete koje određuju akademske jedinice.
5. Za funkcionisanje programa akademske jedinice neophodan je minimlan broj od 20 studenata, izuzev Fakulteta Umjetnosti, gdje se grupa može formirati i sa manje studenata.

**III. RASPORED (ROKOVI) KONKURSA**

Za upis studenata na prvoj godini postdiplomskih (Master) studija, rasporedi su sljedeći:

1. Podnošenje dokumentacije traje od 29.09.2020 do 10.10.2020 sa početkom od 09:00 - 15:00 (prijem dokumentacije će se odvijati svakog dana, sem nedjelje)

2. Prilikom prijave, kandidati moraju dostaviti sljedeću dokumentaciju:

- Ispunjenu aplikaciju, koja se može preuzeti sa internet stranice nakon online aplikacije (http://sems.unhz.eu/AplikimiMaster);

- Izvod rođenih/Ekstrakt (original);

- Original ili noterizovanu diplomu, tačnije potvrdu o diplomiranju;

- Dokaz o akreditaciji visokoškolskih ustanova (za kandidate koji su završili studije u inostranstvu i na privatnim visokoškolskim ustanovama Republike Kosovo);

- Uplatnicu od 2.50€ (uplatnica se preuzima nakon apliciranja).

Kandidati primljeni prilikom prijave semestra plaćaće školarinu u skladu sa AI 17/2014 od 06.05.2014.

3. Prijemni ispit će se održati po sljedećem rasporedu:
   - Fakultet Biznisa 13.10.2020 u 10.00 časova
   - Pravni Fakultet 13.10.2020 u 10.00 časova
   - Fakultet Umjetnosti 13.10.2020 u 09.00 časova

4. Na prijemnom ispitu svi kandidati moraju posjedovati neki od navedenih dokumenata: ličnu kartu, pasoš, vozačku dozvolu, tj. dokumenta bez kojih ne mogu da prisustvuju na prijemnom ispitu,

   Tokom prijemnog ispita, pristup mobilnim telefonima je zabranjen!

   Imajući u obzir situaciju nastalu pandemijom COVID-19, svi kandidati, počev od predaje dokumenata, tokom prijemnog ispita I upisa, moraju poštovati preporuke NIJZK I moraju nositi zaštitne maske.

5. Objavljivanje rezultata sa prijemnog ispita će se realizovati najdalje do 14.10.2020.

**IV. PRAVO ŽALBI I ROK ŽALBI**

Kandidati koji nisu primljeni na prvoj godini postdiplomskih (Master) studija mogu dostaviti žalbu odgovarajućem fakultetu u roku od 3 dana nakon objave rezultata, tačnije do 19.10.2020. Konačna odluka o žalbi se može donijeti samo od strane Komisije za žalbe u Rektoratu.

**V. OBJAVA KONAČNIH REZULTATA I UPIS PRIMLJENIH KANDIDATA**

1. Konačni rezultati na osnovu odluke komisije za žalbe objavljuju se najkasnije do 23.10.2020.
2. Upis primljenih kandidata će se odviti od strane Centralne Administracije Univerziteta "Haxhi Zeka" u Peći, po sljedećem rasporedu:
   - Fakultet Biznisa 26.10.2020 od 09:00 - 15:00 u objektima Fakulteta biznisa;
   - Pravni Fakultet 27.10.2020 od 09:00 - 15:00 u objektima Pravnog fakulteta;
   - Fakultet Umjetnosti 27.10.2020 od 09:00 - 15:00 u objektima Pravnog fakulteta.
3. Za upis, primljeni kandidati moraju dostaviti:
   a) Popunjenu prijavu (koja se uzima tokom upisa u Centralnoj Administraciji UHZ);
   b) Dvije slike formata 6 x 4 cm;
   c) Uplatnica (koja se preuzima sa web stranice) u vrijednosti od **150€** za jedan semester. Uplatnica se može izvršiti u jednoj od banaka.

Za sve druge informacije, kandidati se mogu obratiti akademskim jedinicama ili putem službene internet stranice **www.unhz.eu**

4. Kandidati koji ne uspeju da se upišu u okviru određenih rokova, određuje im se dodatni rok u skladu s uputstvima Ministarstva Obrazovanja i Nauke, koje će biti objavljene na web stranici Univerziteta.

- **Fakultet Biznisa**

| Br. | Studijski program | Master | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Albanski jezik | Bosanski jezik | Ukupno |
| 1. | Menadžment biznisa | 120 | 30 | 150 |
| 2. | Menadžment ljudskih resursa | 50 | / | 50 |

**Prijemni ispit će se održati iz dole navedenih predmeta:**

**a) Za Program Menadžment biznisa:**
   - Osnove Menadžmenta i
   - Uvod u Biznis

**b) Za program Menadžment ljudskih resursa:**
   - Menadžment ljudskih resursa i
   - Strateški menadžment

- **Pravni Fakultet**

| Br. | Studijski program | Master |
|---|---|---|
| | | Redovni |
| 1. | Međunarodno i evropsko pravo | 40 |

**Prijemni ispit će se održati iz dole navedenih predmeta:**

- Međunarodno javno pravo
- Pravo Evropske Unije

Na postdiplomske (Master) studije na Pravnom fakultetu Univerziteta "Haxhii Zeka" u Peći, mogu Biti primljeni kandidati koji imaju zvršene studije Bachelor 4 godine (četiri godine) odnosno 240 ECTS na studiju Prava.

- **Fakultet Umjetnosti**

| Br. | Program studija | Master Redovni |
|---|---|---|
| 1. | Muzičko obrazovanje | 8 |

**Prijemni ispit će se održati iz dole navedenih predmeta:**

1. Muzička pedagogija (metodologjia nastave muzike)
2. Harmonija (Harmonični zadatak za formaciju S, A, T, B a. Harmonizacija soprana
   b. Harmonizacija basa, zadatak se razvija do izmjena)

Na postdiplomske (Master) studije na Fakultetu Umjetnosti Univerziteta "Haxhi Zeka" u Peći, mogu biti primjeni kandidati koji imaju zvršene studije Bachelor 4 godine (četiri godine), odnosno 240 ECTS.

Republika eKosovës

Komuna e Malishevës

Drejtoria Për Arsim dhe Edukim

PRANUAR MË: 29/09/2020
ACCEPTED ON:
PRIMLJENO:
011/888.

*Nr: 11/*

*Më:29.09.2020*

*Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës, nr. 03/L-212,( Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.90/2010), Neni 5 pikës c. të Ligjit për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, nr. 03/L-068, Udhëzimit Administrativ ( MPMS) Nr.07/2017 për rregullimin e Procedurave të Konkursit Publik Neni 4. Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 10/2018 datë: 20.07.2018 Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm. Drejtoria për Arsim dhe Edukim shpall:*

## KONKURS

*Për plotësimin e vendeve të punës*

*Viti shkollor 2020/2021*

| Nr. | Niveli, Shkolla | Pozita | Vendi i lirë/zëvendësim | Numri i pozitave | orë |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | SHFMU" Ibrahim Mazreku" në Malishevë | Edukatore | Zëvendësim i lehonisë me kohë të caktuar | 1 | 20 |
| 1 | SHFMU" Ismail Qemali" në Bellanicë | Gjuhë Gjermane | Vend i lirë | 1 | 8 |

**I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:**

- Formulari i aplikimit
- Rezymeja personale (CV)
- Dokumenti personal(letërnjoftimi ose pasaporta)
- Diplomat e kualifikimit(ose certifikatat), certifikatat në vend të diplomës jo më të vjetra se gjashtë muaj.
- Certifikata që nuk jeni nën hetime
- Dëshmitë e përvojës në institucionet arsimore ( nëse ka)
- Certifikata e lindjes

**II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor**

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kritereve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji Nr 04/L-032 dhe , Ligji Nr. 03/L-068) dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës të MASHT-it (UA Nr 10/2018) si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

- **Kriteret e kualifikimit:** Për vendin e punës edukatore kërkohet kualifikimet ashtu siç planifikohet me UA të MASHT-it për Normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm Nr. 10/2018 datë; 20.07.2018 Neni 3 Edukimi Parashkollor.
- **Kriteret e kualifikimit:** Për vendin e punës Gjuhë Gjermane kërkohet kualifikimet ashtu siç planifikohet me UA të MASHT-it për Normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm Nr. 10/2018 datë; 20.07.2018.

Vetëm në mungesë të kandidatëve nga sqarimi i lartcekur, do të shqyrtohen edhe aplikacionet e kandidatëve me kualifikim më të përafërt.

**III. Mosplotësimi i saktë dhe i qartë i formularit të aplikimit, aplikacionet e pakompletuar dhe ato që dorëzohen pas afatit të konkursit nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.**

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente( jo ata që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi)

SQARIM: Kandidatët mund të konkurrojnë në më shumë shkolla, por me dokumente të veçanta.

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kanë diplomat e nostrifikuara në MASHT.

**Për intervistë do të ftohën ata kandidatë të cilët i plotësojnë kushtet sipas akteve ligjore të cekura.**

Pas plotësimit të dispozitave ligjore dhe kritereve të konkursit publik, kandidatët do t'i nënshtrohen testimit me shkrim dhe testit me gojë sipas nenit 10 dhe 11 të Udhëzimit Administrativ nr. Nr.07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik.

Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për intervistë dhe orari i intervistave publikohet në web-faqen e Komunës së Malishevës.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

**Afati dhe mënyra e aplikimit**

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit më: **29.09.2020 deri më datën: 13.10.2020**

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuara) duhet të dorëzohet përmes protokollit,përkatësisht përmes zyrës së pritjes së palëve, në objektin e ri të Komunës së Malishevës.

MITROVICA
KOMPANIA UJËSJELLËSI RAJONAL SH.A.
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
KOMPANIJA REGIONALNI VODOVOD D.D.

**D P A**

**Departamenti për punë administrative**

| **Mitrovicë** | **/ Nr.** |
|---|---|

Kompania Rajonale Ujësjellësi "Mitrovica" Sh.A. në Mitrovicë, duke u bazuar ne Udhëzimin Administrativ Nr.07/2019 për strukturën, përmbajtjen dhe dorëzimin e raporteve financiare vjetore, me datën 29.09.2020 mori vendim për të shpallë:

## K O N K U R S

**I. (1) Menaxher për Financa dhe Kontabilitet**

**Përshkrimi i punëve dhe detyrave të punës:**

- kordinimi i punëve të dokumentacionit financiar të të tri njësive (Mitrovicë, Vushtrri, Skenderaj),
- pranimi i dokumentacionit dhe shikimi i rregullsisë së tij,
- regjistrimi i tërë dokumentacionit në librat e kontabilitetit,
- regjistrimi i ekstrakteve bankare në librat e kontabilitetit nga bankat ku kompania ka llogarit e hapura si dhe barazimi i tyre me librat e kontabilitetit,
- pranimi i faturave hyrëse, regjistrimi i tyre në kontot adekuate nëpër njisit përkatëse,
- pranimi i fatyrave dalëse si ato të shërbimeve, të ujit, regjistrimi i tyre në librat e kontabilitetit,
- përcjellja e arkës për njisi, arkat e inkasimit ditor dhe arkën e shpenzimeve,
- për secilën njisi arkat e të hyrave dhe shpenzimeve, regjistrimi i tyre në librat e kontabilitetit, barazimi i inkasimeve ditore me shërbimin e inkasimit,
- përpilimi i raporteve financiare mujore, llogaritja e TVSH-së, plotësimi dhe deklarimi mujor i TVSH-së,
- plotësimi dhe deklarimi i formularëve të tatimit në burim,
- plotësimi dhe deklarimi i formularëve për kontribute,
- raportet tremujore në të ardhurat e kompanis dhe dorëzimi i tyre në ATK,
- përpilimi i pasqyrave financiare në bashkëpunim me ZKF si dhe punët plotësuese me urdhër të Kryeshefit Ekzekutiv,
- Pregaditja e dokumentacionit për Auditim të jashtëm si dhe bashkëpunimi me Auditor të Jashtëm,
- Kryen punë dhe detyra tjera sipas Udhëheqësit.

- Përgaditja superiore – Fakulteti Ekonomik,
- Të jetë Kontabilist i çertifikuar(obligative),
- Së paku 3 vite përvojë pune,
- Aftësi të shkëlqyeshme komunikimi dhe bashkëpunimi me Zyrtarin Kryesor Financiar dhe Zyrtarët e Lartë tjerë të Kompanisë.

Dokumentat e kompletuara të cilat duhet të përfshijnë letren përcjellëse, biografin tuaj (CV-në), kopjen e diplomës përkatëse e noterizuar, dëshmin që është Kontabilist i çertifikuar, referencat dhe çertifikatat- të lindjes, shëndetësore, të mos jetë nën hetime dhe i denuar, letërnjoftimi kopja, dëshmi mbi përvojën e punës etj.

Dokumentacioni dorëzohet i fotokopjuar dhe i njejti nuk u kthehet aplikantëve.

Aplikacionet merren dhe i tërë dokumentacioni i kompletuar dorzohet në Drejtorin e KRUM-së, zyra nr. 6.

Afati për aplikim është 15 ditë nga dita e publikimit në të përditshmen Epoka e Re.

Dokumentet që nuk janë të kompletuara sipas konkursit nuk do të shqyrtohen.

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen në:

Zyra Nr.6

Drejtoria e KRUM.

Rr. Bislim Bajgora pn.

Mitrovicë




## Njoftim

Njoftohen të interesuarit se më 08.10.2020 (e enjte), në orën 10:00 në sallën e dekanatit të Fakultetit të Filologjisë të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, kandidati Alban Zeneli do ta bëjë mbrojtjen publike të punimit të doktoratës me titullin: **“Raporti ndërmjet medieve të reja dhe atyre tradicionale në Kosovë (gazeta, radio dhe televizioni përballë portaleve dhe rrjeteve sociale)”**. Ftohen të interesuarit që të marrin pjesë.

## Njoftim

Njoftohen të interesuarit se më 08.10.2020 (e enjte), në orën 13:00 në sallën e dekanatit të Fakultetit të Filologjisë të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, kandidati Faton Ismajli do ta bëjë mbrojtjen publike të punimit të doktoratës me titullin: **“Transformimi i zhanrit në mediet online”.** Ftohen të interesuarit që të marrin pjesë.




## Njoftim

Njoftohen të interesuarit se më 09.10.2020 (e premte), në orën 11:00 në sallën e dekanatit të Fakultetit të Filologjisë të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, kandidati Shemsi Haziri, do ta bëjë mbrojtjen publike të punimit të doktoratës me titullin: **“Zhvillimi i leksikut policor në gjuhën shqipe në Kosovë (përqasje krahasuese Kosovë Shqipëri: periudha 1970 – 2016)”.** Ftohen të interesuarit që të marrin pjesë.




## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ “Fulla” L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330455891.

▶ Valentina Osmani shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme “ Hoxh Kadi Prishtina” Prishtinë.

▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

▶ Lëshoj banës me qira në lagjen “Dardania” në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

**Kërkoj një pastruese për shtëpi. Shtëpi është në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Informatat në tel: 045-336-731**


MEKA
HALAL FOOD
pashtetë pule
gluten free
100 % mish pule
cilësi e garantuar
pa konservues


ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1905
RC cola
0.5L